

Aljula Jubani Maja Gojçaj

MËSOJMË DHE PËRDORIM GJUHËN
NË KOMUNIKIM

GJUHA SHQIPE 4

PËR KLASËN E KATËRT TË SHKOLLËS FILLORE

LIBRI I MËSUESIT/ES



Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore
PODGORICË, 2025

Dr. Aljula Jubani Mr. Maja Gojçaj

GJUHA SHQIPE 4

MËSOJMË DHE PËRDORIM GJUHËN NË KOMUNIKIM

Libri i Mësuesit/es

ALBANSKI JEZIK 4

UČIMO I UPOTREBLJAVAMO JEZIK U KOMUNIKACIJI

Priručnik za nastavnike

Botuesi: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore; Podgoricë

Për botuesin: Mr. Aleksandra Hajduković, drejtoreshë

Kryeredaktor: Mr. Radulle Novović

Redaktor përgjegjës: Llazo Leković

Redaktor: Dimitrov Popović

Recensentë:

Dr. Haxhi Shabani

Mr. Leze Cacaj

Mr. Marjan Lulgjuraj

Dr. Gëzim Diora

Dr. Arben Hoti

Lektor: Albana Lulanaj

Dizajni dhe faqosja: Mr. Svetlana Lolla Miličković

Ilustrimet: Monika Dukaj

Redaktore teknike: Dajana Vukçević

CIP – Каталогизација у публикацији
Национална библиотека Црне Горе, Цетиње

ISBN 978-86-303-2571-7
COBISS.CG-ID 36398852

Këshilli Kombëtar i Arsimit, me vendimin nr. 08/2-119/25-7446-5 datë 16.07.2025
e ka miratuar këtë Komplet të tekstit mësimor për përdorim në shkollat fillore.

Copyright © Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2025

Të dashura mësuese *Të dashur mësues*

Teksti mësimor "Mësojmë dhe përdorim gjuhën në komunikim", shoqëruar me fletoren e punës, është një vijim i drejtpërdrejtë i teksteve të gjuhës shqipe për klasat e 1-rë, 2-të dhe 3-të. Ashtu si edhe ata më parë, ky tekst është përgatitur me synimin për të ndihmuar nxënësit të përvetësojnë gjuhën e tyre amtare përmes të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit. Klasa e katërt shënon kalimin nga cikli i parë në ciklin e dytë, duke përqendruar rritjen e aftësive për të folur, lexuar dhe shkruar. Veçoritë e sistemit të gjuhës standarde shqipe marrin një vend të dukshëm, duke pasqyruar zhvillimin mendor dhe psikik të fëmijëve të kësaj moshe.

Tekstet janë zgjedhur me kujdes për t'u përshtatur me moshën dhe interesat e nxënësve. Për çdo autor, mbetet ndihmë e vlefshme çdo sugjerim nga ana mësuese që do të punojnë me këto materiale. Ushtrimet me pyetje mbi tekstet, menjëherë pas tyre në mësim ose në fletoren e punës, ndihmojnë nxënësit të analizojnë dhe të kuptojnë tekste letrare dhe joletrare, duke vënë theksin në ndarjen e tyre në pjesë, si dhe në mënyrën si lidhen pjesët midis tyre.

Njohuritë gramatikore, paraqiten në mënyrë të thjeshtë, që të jenë sa më lehtësisht të kuptueshme nga nxënësit. Sidoqoftë, konceptet gramatikore paraqiten gjithnjë në shërbim të krijimit të aftësive sa më të mira të nxënësit për t'u shprehur dhe për të përdorur si duhet mjetet e shumta gjuhësore. Qëllimi kryesor është të inkurajojë nxënësit të kuptojnë dhe mbajnë mend tekstin e shkruar. Para analizës, nxënësit pyeten për çfarë dinë ata rreth çështjeve që trajtohen në tekstin që do të lexojnë dhe në mësim.

Punët me shkrim janë një pjesë e rëndësishme e mësimdhënies në klasën e katërt, shihen si mjet komunikimi dhe fëmijëve u mundësohet të shkruajnë për temat që njohin dhe u bëjnë përshtypje. Do të ishte mirë që mësuesit të nxisin nxënësit të zgjedhin vetë tema dhe t'i ndihmojnë ata në zhvillimin e aftësive shprehëse, me shkrim ose me gojë.

Pjesa e fundit flet për hartimin e testeve të shkruara për verifikimin e njohurive të fituara. Rekomandohet përdorimi i Fletores së punës dhe Librit për mësuesin për të zhvilluar një mësim me sa më shumë vlerë dhe interesant, duke i lënë hapësirë mësuesit për të vendosur metodat e realizimit të orëve, në pajtim me karakteristikat e klasës dhe metodologjinë e tyre të mësimdhënies.

PËRMBAJTJA

PJESA E PARË

- MËSIMI 1** Gjuha amtare dhe gjuha zyrtare 5
MËSIMI 2 Gjuha standarde dhe variantet dialektore 6
MËSIMI 3 Teksti dhe pjesët e tij 9
MËSIMI 4 Llojet e teksteve: teksti letrar dhe teksti joletrar 11
MËSIMI 5 Tekste joletrare 12
MËSIMI 6 Shkruajmë letra në mes miqsh dhe letra zyrtare 13
MËSIMI 7 Të shkruajmë rregullore të ndryshme dhe jetëshkrimin tonë 14
MËSIMI 8 Të përshkruajmë botën përreth dhe ngjarje që na interesojnë 16
MËSIMI 9 Gazeta e shkollës 17
MËSIMI 10 Si të sillemi në situata të ndryshme? 18
MËSIMI 11 Të njohim dhe të diskutojmë rregullat e mirësjelljes 19
MËSIMI 12 Si të shprehemi me mirësjellje (format e duhura gramatikore) 20

PJESA E DYTË

- MËSIMI 13** Përdorimi i shkronjës së madhe 22
MËSIMI 14 Disa raste të shkrimit të zanores *ë* 23
MËSIMI 15 Shkrimi i bashkëtingëlloreve *//* dhe *dh* 24
MËSIMI 16 Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit 25
MËSIMI 17 Shkrimi i pjesëzave mohuese *nuk* dhe *s'* + folje 26

PJESA E TRETË

- MËSIMI 18** Emrat e përgjithshëm dhe emrat e përveçëm 28
MËSIMI 19 Gjinia e emrit 29
MËSIMI 20 Numri i emrit 31
MËSIMI 21 Shumësi i disa emrave në gjuhën shqipe 33
MËSIMI 22 Mbiemri i nyjshëm dhe i panyjshëm. Gjinia dhe numri i mbiemrit. 34
MËSIMI 23 Përemrat vetorë 35
MËSIMI 24 Foljet kam dhe jam në kohën e tashme, të pakryer dhe të ardhme 36
MËSIMI 25 Koha e tashme dhe e ardhme e foljes 37
MËSIMI 26 Koha e pakryer dhe e kryer e thjeshtë e foljes 38

PJESA E KATËRT

- MËSIMI 27** Llojet e fjalive sipas kuptimit 40
MËSIMI 28 Fjalitë pohore dhe mohore; fjalitë e thjeshta dhe të përbëra 41
MËSIMI 29 Pjesët kryesore të fjalisë 42
MËSIMI 30 Pjesët plotësuese të fjalisë 45

PJESA E PARË

MËSIMI 1

GUHA AMTARE DHE GUHA ZYRTARE

Arritjet e të nxënit: Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë:

- Të kuptojë rëndësinë e arsimimit në gjuhë amtare.
- Të dallojë mënyrat e komunikimit.
- Të dallojë mënyrën e komunikimit gjuhësor dhe jogjuhësor.
- Të marrë pjesë në lojëra për zhvillimin e komunikimit.
- Të njohë veçoritë themelore të gjuhës amtare.
- Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë të thotë gjuhët që fliten në Mal të Zi.
- Të thotë gjuhët që ka pasur rast t'i dëgjojë ose t'i mësojë.
- Të kuptojë/sqarojë rëndësinë e mësimit të gjuhëve të huaja.

Metodat dhe teknikat: Stuhi mendimesh, biseda, punë në grupe.

Korrelacion: natyra, njohuri për shoqërinë

Fjalë kyçe: gjuhë shqipe, gjuhë malazeze, komunikim verbal dhe joverbal

Mjetet e mësimit: teksti mësimor, fletore e punës, projektor, hartë.

Evokim:

Bisedë me nxënësit - si lind nevoja e komunikimit që nga lindja?

Sa janë të kuptueshme ato komunikimet e para?

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve:

Cila është gjuha që përdoret kur flasim në shtëpi, në rrethin shoqëror, në shkollë etj. ...?

Cilat gjuhë të tjera mësoni në shkollë?

A keni dëgjuar për ndonjë gjuhë tjetër?

Realizim kuptimi:

Në tabelë shkruajmë "Gjuha jonë", ku nxënësit përshkruajnë me fjalë gjuhën, shprehin lirshëm mendimet e tyre lidhur me gjuhën, si: *e ëmbël, e bukur, e mirë* etj...

Para tabelës nxirret një nxënës i cili me anë të pantomimës përshkruan një fjalë të paraqitur në një ilustrim të fshehur nga nxënësit e tjerë, detyra e nxënësve është të zbulojnë se për çfarë bëhet fjalë në bazë të asaj që nxënësi sqaroi me gjepte pa folur. Vërejnë që komunikimi mund të bëhet në disa mënyra.

Ushtrimi nr. 2 në tekstin mësimor.

Me lehtësi dallojnë imazhet që paraqesin shenja gjuhësore nga ato jogjuhësore. Imazhet jogjuhësore pasqyrojnë kryesisht lehtësinë e përcaktimit të fjalisë.

Para se të vazhdohet ushtrimi nr. 3, nxënësit ndahen në disa grupe

Secilit grup i përcaktohet një shtet, për të cilin nxënësit në grup do të shkruajnë të gjitha të dhënat që dinë për të: si quhet populli i këtij shteti, cila gjuhë përdoret, shkruajnë fjalë që i dinë në këtë gjuhë ose ndonjë përsëritje etj.



Ushtrimi 3:

Udhëzohen nxënësit të gjejnë emrat e shteteve në mesin e shkronjave dhe të dallojnë gjuhën që flitet në këto shtete.

Ushtrimi 4:

Ftohen nxënësit që të shkruajnë sa më shumë fjalë me ndihmën e prindërve, të cilat nuk janë në gjuhën zyrtare. Diskutohet në klasë përdorimi i drejtë i tyre në gjuhën zyrtare.

Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur. (Kontrollohet puna e tyre.)

Punë me fletore pune:

Rikujtojmë se cila është gjuha zyrtare në Mal të Zi.

Në cilat vende është gjuha shqipe gjuhë zyrtare dhe pse?

Reflektim:

Ushtrimi 2:

Nxënësit, në mënyrë të pavarur, u përgjigjen pyetjeve të dhëna, duke vënë re qartë dallimin në mes gjuhës amtare dhe gjuhës së huaj.

Ushtrimi 3:

Nxënësit sjellin fotografi të ndryshme të tabelave në vendin e tyre dhe diskutohet mbi kuptimin dhe rëndësinë e tyre, mënyrën e paraqitjes gjuhësore apo jogjuhësore.

Së bashku me mësimdhënësit vështrojnë shenjat në afërsi të shkollës dhe diskutojnë lidhur me kuptimin dhe gjuhën në të cilën ato shenja janë paraqitur (vendkalimi për këmbësorë, fëmijët në rrugë, shenjat e komunikacionit, emërtimet e vendeve etj.).

Detyrë:

Ushtrimi 5 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

MËSIMI 2

GJUHA STANDARDE DHE DIALEKTET

Arritjet e të nxënit: Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë:

- Të kuptojë dhe dallojë të folurit e thjeshtë (të rrethit), të folurit në dialekt dhe të folurit e standardizuar.
- Të vërë re dallimin mes dy dialekteve.
- Të punojë me fjalorin, duke shquar fjalët e huaja në përdorimin e përditshëm dhe fjalët gjegjëse në gjuhën standarde.
- Të kuptojë dhe të krahasojë nocionet: *gjuhë amtare* (gjuha standarde dhe gjuha jostandarde) *gjuhë zyrtare* dhe *gjuhë e huaj*.

Metodat dhe teknikat: Stuhi mendimesh, të nxënit në bashkëpunim, punë në grupe, lojë me role.

Korrelacion: njohuri për shoqërinë

Fjalë kyçe: gjuhë amtare, gjuhë zyrtare, gjuhë e huaj

Mjetet e mësimit: teksti, fletore e punës, kompjuter (tablet)

Evokim:

Diskutohet me nxënësit për gjuhën e të folurit, të cilën ata e përdorin në shkollë, në shtëpi.

Cila gjuhë përdoret në emisione të televizionit apo radios, të cilat i dëgjojnë?

Si dallohet mënyra e komunikimit në shtëpi dhe në shkollë?

Nxënëve u sillen video të emisioneve të fëmijëve nga dy treva të ndryshme, krahasojnë mënyrën e të folurit, vërejnë ngjashmëritë dhe dallimet mes variantit të të folmeve.

Realizim i të kuptuarit:

Lexohen fjalët e vendosura në gjethe dhe së pari veçohen ato që përdoren në shqipen standarde: qeni, macja, domatet, hëna, qeni, qumështi, nëna, xhaxhai, dritare, zemra.


Më pas ato krahasohen me format dialektore geqe e toske, si: mica, mollatarta, tamli, hana, moca, nana, axha, penxhere, zëmra. Në fund, duke gjetur gjegjëset e tyre në të folmen e nxënësve arsyetohet se si kjo e folme i përket dialektit gegë.

qeni, macja, domatet, hëna, qeni, domatet, qumështi, mica, mollatarta. tamli, hana, moca, nëna, nana, axha, xhaxhai, dritare, penxhere, pixhere, zemra, zëmra

Diskutohet me nxënësit për historikun e zhvillimit të gjuhës standarde shqipe, e cila ka qenë synim i shumë brezave, atdhetarëve e dashamirësve të saj duke kaluar nga variantet dialektore e për të arritur në gjendjen e sotme.

Për formimin e gjuhës standarde dhe të drejtshkrimit të saj, ngjarje e rëndësishme ishte Kongresi i Drejtshkrimit, i mbajtur me 1972.

Në tabelë shkruhen disa fjalë të shkruara në variantin gegë dhe toskë



Vërejnë ngjashmëritë dhe dallimet midis dy dialekteve. Theksohet se këto dallime nuk janë aq të mëdha, sepse folësit e tyre mund të kuptohen me njëri-tjetrin pa vështirësi.

Nëpërmjet shembujve konkretë, paraqiten fjalët e gjuhës standarde dhe krahasohen ato me dy dialektet e tjera:

Gjuha standarde Gegërisht Toskërisht

vajzë çikë çupë

djalë voc çun

Kuptojnë se gjuha standarde shqipe dallohet për praninë e rregullave dhe normave që duhen zbatuar gjatë përdorimit të gjuhës.



Ushtrimi nr 1.

Teksti mësimor, nxënësi në mënyrë të pavarur plotëson kërkesën e detyrës.

Ushtrimi nr. 2.

Nga poezia e dhënë dallojnë fjalët e nënvizuara duke i dalluar dialektin në të cilin janë shkruar, ndërsa në ushtrimin më poshtë po të njëjtat fjalë i shkruajnë në gjuhën standarde.

Ushtrimi nr. 4. Mësuesi lexon pohimet e dhëna, ndërsa nxënësit përgjigjen nëse ato janë shkruar saktë apo gabim.

Ushtrimi nr. 5. Nxënësit ndahen në 5 grupe, secilit grup i përcaktohet një imazh nga teksti dhe shkruajnë sa me shumë fjalë të cilat përdoren për këto imazhe në gjuhën shqipe. Diskutohet dhe shënohen përgjigjet e çdo grupi.

Reflektim.

Punë me fletore pune

Ushtrimi nr 1.

Mësuesi krijon situata të ndryshme komunikimi duke u dhënë role të ndryshme nxënësve.

Rasti 1. Një nxënës ka munguar në shkollë dhe kërkon nga shoku që t'i nisi mësimet, të cilat i kanë mësuar (si do t'i drejtohet atij?), çfarë fjalësh do të përdorë?).

Rasti 2. Nxënësi ka nevojë që të mungojë në shkollë për dy ditë dhe kërkon leje nga mësimdhënësi (mënyra e komunikimit me mësimdhënësin, që vë në dallim komunikimin me bashkëmoshatarët).

Rasti 3. Nxënësi ka nevojë të blejë në librari një fletore dhe një laps (komunikimi më një të panjohur).

Vihen re mënyrat e ndryshme të komunikimit.

Ushtrimi nr. 2.

Ftohet në klasë gjyshi ose gjyshja e një nxënësi dhe rrëfen për jetën e tyre.


Mënyra e të jetuari, e veshjes, e të ushqyerit, aktivitetet, punët dhe detyrat etj.

Udhëzohen nxënësit të shkruajnë një histori, të cilën ua ka treguar gjyshi, gjyshja ose ndonjë i moshuar.

Ushtrimi nr. 3. Mësuesi i orienton nxënësit të provojnë të ndajnë fjalët e dhëna në dialektin gegë dhe toskë.

Detyrë:

Ushtrimi 5 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.



Arritjet e të nxënit: Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë:

- Të kuptojë rëndësinë e gjuhës si mjet komunikimi.
- Të marrë pjesë në lojëra për zhvillimin e komunikimit
- Të vërejë kompozimin e tekstit (hyrje, zhvillim, përfundim) dhe sqaron rolin e tyre.
- Të shkruajë tekste me strukturë të thjeshtë në përshtatje me temën e dhënë apo të përzgjedhur sipas dëshirës.

Metodat dhe teknikat: diskutim për njohuritë paraprake, demonstrim, punë në grupe.

Korrelacion: njohuri për shoqërinë

Fjalë kyçe: hyrje, zhvillim, mbyllje.

Mjetet e mësimit: teksti mësimor, fletore e punës, tabela, shkumësi, projektor.

Evokim:

Kujto!

Shkronja - A, B, C, D.

Rrokje - MA, MI, NE, NA

Fjalë – DJALË, VAJZË, SHKOLLË...

Fjali - NE JEMI NË KLASËN E KATËRT.

Fjalitë, duke u lidhur njëra me tjetrën, formojnë një tekst.

Çdo fjali e tekstit ka shenjat e pikësimit. Teksti shkruhet në tabelë ose paraqitet në projektor.

Sill ndërmend për një çast se ç' lëvizje e çuditshme bëhet në të gjithë botën! Kudo njerëzit kanë nevojë për dritën e shkollës, për diturinë. Sa në errësirë do të ishte bota pa to! Mendo sa të mjerë janë ata njerëz që nuk dinë se ç' është mësimi.

U përgjigjen pyetjeve:

Sa fjali ka teksti? Si janë të lidhura?

Teksti i dhënë përbëhet nga 4 fjali të lidhura me kuptim.

Mësuesi kërkon nga nxënësit që të përshkruajnë një ditë të zakonshme të tyre, duke filluar nga aktivitetet e mëngjesit, mesditës dhe të darkës.

Veçojnë fillimin e rrëfimit në mëngjes, pastaj zhvillimin apo aktivitetet gjatë ditës dhe mbylljen në darkë apo mbrëmje.

Realizim kuptimi:

Mësuesi nxjerr disa figura të shkollës, librit, nxënësit, çantës etj, kërkon që nxënësit të formojnë nga një fjali për secilën. Përgjigjet e nxënësve shkruhen në tabelë duke formuar një tekst.

Mësuesi kërkon që nxënësit të lexojnë në fletë të përgatitura tekstin “I dashur ditar”, i ndarë në tri pjesë, ku pjesët e tregimit nuk janë të renditura sipas ngjarjes.

Këto pushime janë çdo ditë e më të bukura, nga deti në mal. Do t'i mbaj mend shumë gjatë. Shihemi nesër!



Edhe sot shkuam në mal, që në mëngjes. Ajri ishte i pastër e na mbushi mushkëritë plot. Me gjithë atë energji dhe duke luajtur me njëri-tjetrin, u ulëm të hanim me oreks. Sa shumë na shijuan ushqimet!

I dashur ditar,

Ka disa javë që shkruaj rregullisht si po i kaloj këto ditë të bukura pushimesh, sepse nuk dua t'i harroj.

Detyrë e nxënëve është të lexojnë rrëfimin dhe të rendisin ngjarjen si duhet. Në këtë mënyrë do të veçojnë pjesën hyrëse, zhvillimin dhe përfundimin.

I dashur ditar,

Ka disa javë që shkruaj rregullisht si po i kaloj këto ditë të bukura pushimesh, sepse nuk dua t'i harroj.

Edhe sot shkuam në mal, që në mëngjes. Ajri ishte i pastër e na mbushi mushkëritë plot. Me gjithë atë energji dhe duke luajtur me njëri - tjetrin, u ulëm të hanim me oreks. Sa shumë na shijuan ushqimet!

Këto pushime janë çdo ditë e më të bukura, nga deti në mal. Do t'i mbaj mend shumë gjatë. Shihemi nesër.

Mësuesi sqaron që pjesa hyrëse paraqet qartësinë e temës, qëllimin e tekstit;

zhvillimi - paraqet mesazhin e plotë për tekstin; përfundimi- konkludim për të gjithë tekstin.

Mbas aktivitetit të dhënë nxënësit janë në gjendje të përfundojnë kërkesën e detyrës së parë të tekstit mësimor.

Paraqitët ilustrimi “libri tërheqës”, mbi bazën e të cilit nxënësit do të krijojnë një tekst duke u përgjigjur pyetjeve.

Hyrja: Kur, ku, çfarë bën,

Zhvillimi: si ishte vendi, çfarë ndodhi?

Mbyllja: si përfundon?

Reflektim:

Ushtrimin nr 1 dhe 2 nxënësit e punojnë në mënyrë të pavarur.

Punë me fletore pune.


Ushtrimi nr 1. Nxënësi plotëson tabelën duke treguar së çfarë shkruajnë në secilën pjesë të tekstit.

Ushtrimi nr 2. Rendisin ngjarjen duke vënë në vendin e duhur çdo pjesë të tekstit.

Ushtrimi nr 3. Përshkruajnë një ditë të zakonshme duke bërë kujdes për pjesët e tekstit.

Detyrë:

Ushtrimi 4 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.



Arritjet e të nxënit: Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë:

- Të kuptojë natyrën e teksteve, të parafranojë, interpretojë dhe dallojë sipas formës së shkrimit dhe tematikës.
- Të shprehë mesazhin e një teksti letrar, përmes njërës nga format shprehëse: të folurit, të shkruarit, duke vizatuar apo duke dramatizuar.
- Të tregojë përshtypjet e veta mbi një tekst.

Metodat dhe teknikat: Të nxënit në bashkëpunim, punë në grupe, të mësojmë duke luajtur.

Korrelacion: njohuri për shoqërinë, Kultura e artit figurativ.

Fjalë kyçe: tekst letrar, tekst joletrar, udhëzime

Mjetet e mësimit: teksti mësimor, fletore e punës, kompjuter (tablet)

Evokim:

Në tabelë paraqitet një lojë për nxënësit, loja me zare. Në anën tjetër janë të shënuara udhëzimet se si duhet luajtur loja. Secili nxënës i hedh zaret 5 herë dhe në tabelë shënon numrin e pikëve të fituara. Nxënësi, që fiton më shumë pikë është fitues.

Parashtrohet pyetja: si do ta luanin nxënësit lojën, nëse nuk do të merrnin udhëzime nga mësimdhënësi?

Në vazhdim paraqitet një strofë e një poezie, analizohet dhe komentohet së bashku me nxënësit. Vihet re dallimi mes teksteve?

Cili ishte dallimi në mes poezisë dhe tekstit me udhëzime?

Realizim kuptimi:

Teksti është njësi komunikimi dhe si i tillë ka edhe funksionin që të komunikojë një mesazh.

Kuptojmë se tekstet mund të jenë letrare dhe joletrare. Vihet re dallimi mes tyre.

Teksti letrar përcjell emocione. Përmes tij shprehet fantazia, ndërsa teksti joletrar nuk ka elemente artistike emocionale.

Në tabelë paraqiten tekstet letrare dhe tekstet joletrare

Lloje të teksteve letrare janë: tregimi, romani, poezia drama etj.

Lloje të teksteve joletrare janë: gazeta, udhëzime, receta etj.

Ushtrimi nr. 1.

Lexojnë fragmentet duke i renditur, sipas karakteristikës së tyre, në letrare dhe joletrare, argumentojnë përgjigjet e dhëna.

Plotësojnë ushtrimin nr. 2 dhe 3, duke diskutuar së bashku me shokët dhe mësuesin për përgjigjet e sakta.

Nxënësit ndahen në 4 grupe. Secili grup në temë ka sportin.

Grupi 1. Ka detyrë të shkruajë një tregim për sportin e preferuar.

Grupi 2. Një poezi për sportin e preferuar.

Grupi 3. Një artikull për gazetën.

Grupi 4. Shkruan disa këshilla për arritjen e suksesit në një sport.



Ushtrimi nr. 4. Pas punës në grup shkruajnë me lehtësi një tekst letrar ose joletrar për sportin e tyre të preferuar!

Reflektim:

Punë me fletore pune.

Plotësojnë përkufizimet dhe përgjigjen në pyetjet e dhëna.

Detyrë:

Ushtrimi 5 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

MËSIMI 5

TEKSTE JOLETRARE

Arritjet e të nxënësve: Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë:

- Të mësojë, të identifikojë dhe të kuptojë llojet e ndryshme të teksteve joletrare.
- Të zhvillojë aftësitë për të lexuar dhe analizuar këto tekste, duke nxjerrë informacionin kryesor dhe duke përdorur informacionin për qëllime të ndryshme.

Metodat dhe teknikat: bashkëbisedim, punë në grup.

Korrelacion: njohuri për shoqërinë, art figurativ.

Fjalë kyçe: tekste jo letrare, tekste informuese, tekste përshkruuese, tekste udhëzuese.

Mjetet e mësimit: teksti mësimor, fletore e punës, projektor, receta, gazeta e materiale plotësuese me tekste të ndryshme.

Evokim:

Fillohet me pyetje të hapura për të ngjallur interesin dhe për të nxitur mendimin e nxënësve. U kërkohet të flasin për libra të ndryshëm që kanë në shtëpi, përveç librave të shkollës.

- Kërkimi i lidhjeve midis teksteve joletrare dhe situatave të jetës reale. Për shembull, diskutime si një manual përdorimi mund të ndihmojë në funksionimin e një pajisjeje apo si një artikull lajmesh mund të na informojë mbi ngjarjet e fundit.
- Përdorimi i krahasimeve për të shpjeguar ndryshimet mes teksteve letrare dhe joletrare. Për shembull, diskutimi i një historie imagjinare krahasuar me një përshkrim shkencor të një eksperimenti.

Flasin së bashku për udhëzues të ndryshëm.

Mësuesja u tregon si luhet loja emra qytetesh, gjuhësh, banorësh. Çdo nxënës zgjedh një qytet dhe e përshkruan. Më pas, tregon recetën e gatimit që i pëlqen më shumë apo si duhet të vepron kur janë me grip. Në fund, udhëzohen të diskutojnë për veçoritë e secilit prej teksteve.

- Shpjegoni se tekstet informuese kanë për qëllim të japin informacion mbi një temë të caktuar. Ato përdoren në artikuj gazetalesh, raporte shkencore, lajme etj.
- Shpjegoni se tekstet udhëzuese japin udhëzime ose këshilla për të kryer një veprim. Ato përdoren në receta gatimi, manuale përdorimi, udhëzime për lojëra etj.
- Shpjegoni se tekstet përshkruuese japin një përshkrim të detajuar të një objekti, vendi ose procesi. Ato përdoren në përshkrime vendesh, përshkrime produktesh etj.

Realizim kuptimi:

Me këtë metodologji të integruar dhe të strukturuar, nxënësit do të kenë mundësi të njohin dhe të kuptojnë në thellësi llojet e teksteve joletrare dhe do të pajisen për t'i aplikuar këto aftësi në komunikim dhe përmbushjen me sukses të qëllimeve të komunikimit.

Në vijim punohet me ushtrimet në librin e nxënësit dhe në fletoren e punës, duke i ndihmuar se si të zbërthejnë veçoritë e tekstit dhe për të identifikuar llojet e tyre.

Detyrë:

Ushtrimi 4 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

MËSIMI 6

SHKRUAJMË LETRA MES MIQSH DHE LETRA FORMALE

Arritjet e të nxënës: Në fund të mësimi nxënësi do të jetë i aftë:

- Të njohë veçoritë themelore të letrës dhe të kartolinës.
- Të njohë funksionin e tyre si mjet komunikimi.
- Të shkruajë në mënyrë të pavarur një letër ose kartolinë.

Metodat dhe teknikat: bashkëbisedim, punë në grup.

Korrelacion: njohuri për shoqërinë, Kultura e artit figurativ.

Fjalë kyçe: letra zyrtare, jozyrtare

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore e punës, projektor.

Evokim:

Diskutohet në klasë për mënyrën e komunikimit të tyre në klasë. Komentojnë komunikimin e tyre me bashkëmoshatarët dhe me mësuesin. Vihet në pah dallimi midis dialogut me shokun a shokën dhe me mësuesin apo dikë më të moshuar. Përveç komunikimit të tillë nxënësit emërtojnë edhe mënyra të tjera të komunikimit nëpërmjet telefonit, e-mailit, letrave etj. Nxënësit kuptojnë që letrat janë njëra nga mënyrat me anë të cilës mund të komunikojnë.

Realizim kuptimi:

Më anë të projektorit ose vizatimit në tabelë paraqitet një letër të cilën mësimdhënësi së bashku me nxënësit do t'i drejtojnë kryetarit të komunës. Me anë të kësaj letre kërkohet që kryetari t'u krijojë mundësinë fëmijëve të vizitojnë komunën dhe të njihen me punën në këtë institucion.

Lexohen informacionet rreth letrës zyrtare dhe jozyrtare.

Letra jozyrtare i shkruhet një njeriu të afërt dhe fillon me fjalët *I dashur/e dashur* dhe mbyllet me fjalët *me dashuri, përqaftim, për zemërsisht*. Këto letra kanë mjaft shprehje emocionale.

Letra zyrtare i drejtohet dikujt që përfaqëson një institucion apo mban funksione zyrtare. Letrën e fillojmë me *I nderuar / e nderuar*, duke e dhënë të plotë detyrën që kryen personi të cilit i drejtohet letra. Mbas rikujtimit vazhdojnë së bashku me mësimdhënësin të plotësojnë letrën drejtuar kryetarit. Plotësojnë me kujdes të gjitha pjesët e letrës. Emrin, kujt i drejtohet, përshëndetjen, përshkrimin, kush e shkruan, datën.

Lexohen modelet e letrave të dhëna në tekstin mësimor dhe diskutohet rreth tyre.

Çfarë kanë të përbashkët të dyja llojet e letrave?



Në cilën nga letrat përdoren shprehje më të afërta? Pse?

Në cilën nga letrat përdoren shprehjet më zyrtare?

Si fillojnë dhe si mbarojnë letrat zyrtare dhe jozyrtare.

Mësimdhënësi kërkon që nxënësit të shkruajnë emrin e tyre në një fletë. Të gjithë emrat e nxënësve mbulohen dhe secili nxënës me sy të mbyllur merr njëren nga fletët, në të cilën shkruan emrin e shokut/shoqes. Mbasi secili të përcaktojëse kujt do t'ia drejtojë letrën, fillojnë të shkruajnë një letër për shokun, duke treguar për shoqërinë që kanë. Së bashku me mësimdhënësin, mund të organizohet një vizitë në postë dhe dërgohen letrat në adresë të nxënësve. Në këtë mënyrë, do të shkëmbejnë letra me njëri-tjetrin.

Gjithashtu, mësimdhënësi diskuton me nxënësit mbi format e tjera të komunikimit me shkrim, ndër to, dërgimi i një mesazhi elektronik me e-mail. Në këtë rast, u shpjegon nxënësve edhe ku shkruhet qëllimi i mesazhit (lënda), adresa e marrësit të mesazhit dhe ku shkruhet teksti i letrës.

Reflektim rreth të kuptuarit:

Udhëzohen në mënyrë të njëjtë të përgatisin dhe të shkruajnë një kartolinë urimi.

Plotësojnë kërkesat e ushtrimeve në vazhdim në mënyrë të pavarur.

Detyrë:

Ushtrimi 4 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

MËSIMI 7

TË SHKRUAJMË RREGULLORE TË NDRYSHME DHE JETËSHKRIMIN TONË

Arritjet e të nxënësve: Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë:

- Të dallojë të drejtat dhe përgjegjësitë e veta.
- Të dallojë strukturën e dhënë të një jetëshkrimi.
- Të përshkruajë me fjalë apo shkrim veten, shokun / shoqen.
- Të njohë dhe të shkruajë rregulla të ndryshme.

Metodat dhe teknikat: bashkëbisedim, punë në grup.

Korrelacion: njohuri për shoqërinë, art figurativ.

Fjalë kyçe: letra zyrtare, jozyrtare

Mjetet e mësimit: teksti mësimor, fletore e punës, projektor.

Evokim:

Mësuesi kërkon që nxënësit të ulin kokën dhe të dëgjojnë mësuesin dhe të gjejnë se ku janë vendet që ai përshkruan.

Një oborr i madh me shumë fëmijë që luajnë e lodrojnë.

Një dhomë e madhe me shumë fëmijë, shumë tavolina e shumë libra e fletore.

Mësuesi kërkon që nxënësit të përshkruajnë shkollën dhe klasën e tyre.

Nxënësit kuptojnë që klasa është një vend ku një grup nxënësish-fëmijësh kalojnë një kohë të caktuar së bashku.

Fëmijët vijnë nga familje të ndryshme dhe me mendime të ndryshme.

Nxënësit në klasë duhet të mirëkuptohen dhe të bashkëpunojnë ndërmjet tyre. Për këtë arsye, janë të detyruar të zbatojnë rregulloren e shkollës dhe rregullat e vendosura në klasë.

Realizim kuptimi:

Së bashku me nxënësit vendos rregullat e shkollës dhe të klasës, të cilat nxënësit duhet t'i respektojnë.

Nxënësit ndahen në grupe, dy grupeve u përcaktohet të shkruajnë rregullat që ata mendojnë se duhet të zbatojnë në shkollë, ndërsa dy grupeve të tjera, rregullat që ata mendojnë se duhet të zbatojnë në klasë. Së bashku me nxënësit, arrihet në përfundimin mbi rregullat e shkollës dhe të klasës, të cilat vendosen në një kënd të klasës.

Rregullat e shkollës

- Të shkojmë në shkollë në orarin e duhur.
- Të mbajmë pastër mjedisin e shkollës.
- Të mirëmbajmë mjetet e shkollës.
- Të respektojmë personelin ndihmës mësimor.
- Të mbajmë qetësi në shkollë.

Rregullat e klasës

- Jam i vëmendshëm në mësim.
- Flas me leje.
- Kërkoj ndihmë.
- Nuk shqetësoj shokun, shoqen.
- Jam pozitiv në klasë.
- Bashkëpunoj në veprimtari.
- Mbaj higjienën në klasë.
- Nuk bërtas dhe nuk grindem me shokë.

Mbas përcaktimit të rregullores së klasës, mësuesi kërkon që nxënësit të zbatojnë rregullat e klasës, gjithashtu edhe përgjegjësit që do të mbajnë dhe do të kontrollojnë këto rregullore në klasë.

Nxënësit përcaktojnë emrat e disa nxënësve përgjegjës për këto detyrime. Nxënësit, që përcaktohen nga shokët, përshkruajnë veten e tyre dhe mënyrën si ata do të përkujdesen që këto rregulla të klasës të zbatohen.

Përcaktohet kryetari i klasës, nënkryetari, arkëtari, përgjegjësit e higjienës etj.

Nxënësit plotësojnë kërkesat e detyrës së tekstit mësimor nga 1-4 në mënyrë të pavarur.

Reflektim.

Punë me fletore pune.

Mësuesi kërkon që nxënësit të shkruajnë rregullat, që duhet të respektojnë në shtëpi.

Ushtrimin nr. 3 dhe nr. 4 e punojnë në mënyrë të pavarur.

Detyrë:

Ushtrimi 4 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.



Arritjet e të nxënës: Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë:

- Të shkruajë me fantazi për temën e dhënë.
- Të tregojë situata të ngjashme me ato të personazheve të tregimeve.

Metodat dhe teknikat: bashkëbisedim, punë në grup.

Korrelacion: njohuri për natyrën.

Fjalë kyçe: përshkruajmë, ngjarje reale, ngjarje joreale.

Mjetet e mësimit: teksti mësimor, fletore e punës, projektor.

Evokim:

Mësuesi u thotë nxënëve se ka në mend emrin e një kafshe dhe figurën e kafshës e ka të kthyer përmbys. Nxënësit provojnë të zbulojnë kafshën që mësuesi ka menduar. Pas çdo përgjigjeje të gabuar, mësuesi paraqet nga një të dhjetën për këtë kafshë: *e madhe, e vogël, i bukur e bukur, punëtor, punëtore, ka ngjyrë... ka lëkurë... ushqehet me...* përshkruan kafshën, deri sa nxënësit të zbulojnë se për cilën kafshë bëhet fjalë.

Në të njëjtën mënyrë vazhdon edhe me një lloj bime, *ku rritet, si duket, çfarë përfitojmë* etj...

Mësuesi kërkon nga nxënësit që të përshkruajnë një takim të tyre në pyll me luanin dhe një takim të tyre me trëndafilin në fushë.

Në rastin e parë, situata është e tillë ku nxënësi gjindet para luanit në pyll dhe duhet të krijojë miqësi me luanin që të shpëtojë dhe situata e dytë është kur nxënësi takon trëndafilin në fushë dhe kërkon nga ai ndihmë që të gjejë trëndafilin më të bukur për t'ia dhuruar nënës së tij.

Krijojnë dy situata: situata e parë duhet të jetë reale, diçka që mund të ndodhë dhe situata e dytë jo reale diçka, që nuk mund të ndodhë p. sh. nga situata e parë në takim me luanin, nxënësi kërkon ndihmë nga ndokush dhe mundohet të ikë apo të ngjitet në ndonjë pemë, ndërsa situata tjetër fillon bisedimin me luanin dhe shoqërimin me të.

Rasti me trëndafilin, kur nxënësi shkon në fushë, këput trëndafilin e parë që takon dhe ia sjell nënës apo biseda me trëndafilin, duke kërkuar një trëndafil me të bukur.

Vine re se të dy rastet mund të kenë situata reale dhe joreale apo imagjinare. Në këtë mënyrë nxënësit kuptojnë tekstin real dhe joreal, i cili mund të jetë edhe joreal, por me personazh real.

Nxënësit lexojnë rrëfimet e dhëna në tekstin mësimor dhe përshkruajnë me fjalë të veta, duke vënë në dukje rrëfimet reale dhe joreale.

Reflektim.

Ushtrimi nr. 1. Udhëzohen të plotësojnë tekstin si t'u duket më e përshtatshme, pasi e lexojnë fillimin.

Ushtrimi nr. 2 dhe 3 punohen në mënyrë të pavarur.

Punë me fletore pune.

Nxënësit lexojnë tekstin dhe u përgjigjen pyetjeve të dhëna.

Ushtrimi nr. 2

Nxënësit udhëzohen të shkruajnë një tregim të vërtetë apo të trilluar duke përcaktuar personazhet, vendin, kohën dhe ngjarjen.

Ushtrimi nr. 3 punohet në mënyrë të pavarur.

Detyrë:

Ushtrimi 4 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

MËSIMI 9

GAZETA E SHKOLLËS

Arritjet e të nxëniet: Në fund të mësimit nxënësi është i aftë:

→ Të lidhë botën letrare me botën e përvojës së vet.

→ Të krijojë përvojë për t'u marrë me aktivitete jashtë mësimt.

Metodat dhe teknikat: bashkëbisedim, punë në grup.

Korrelacion: Njohuri për shoqërinë.

Fjalë kyçe: gazetë, artikull.

Mjetet e mësimt: teksti mësimor, fletore e punës, projektor.

Evokim.

Paraqiten në projektor disa pamje nga gazetatat e ndryshme shkollore. Diskutohet edhe për gazetën e shkollës.

Mësuesi i fton nxënësit të diskutojnë për aktivitetet e tyre gjatë vitit shkollor, sjell fotografi të nxënësve në aktivitete të ndryshme dhe vizita të ndryshme që kanë pasur gjatë vitit.

Mësuesi paraqet në një tabak letre një zemër në të cilën do të ngjiten fotografitë e të gjitha aktiviteteve gjatë vitit.

Shoqëruar me fotografi, mësuesi së bashku me nxënësit, përshkruajnë me disa fjalë aktivitetin e paraqitur: vizita në postë, vizita në shtëpinë e shëndetit, aktivitete me rastin e ditës ekologjike, festa e shkollës, Dita e flamurit, shëtitje me klasën, ditë sporti etj.

Me ndihmën e fotografive dhe përshkrimit të tyre, nxënësit formojnë një artikull, i cili mund të publikohet në gazetën e shkollës.

Realizim kuptimi.

Nxënësit nxiten të kërkojnë informacione mbi gazetatat e shtypura, por edhe ato elektronike.

Nga përgjigjet e pyetjeve të ushtrimit nr. 1, nxënësit fitojnë ide dhe nxiten të përgatisin një projekt të përbashkët.

Mësuesi tregon disa informacione, të cilat mund të përdoren për gazetën e shkollës, p.sh.: një intervistë me ndonjë sportist nga vendi, përgatitja e kartolinës dhe poezisë për nënën me rastin e festës së nënës apo mësueses etj.

Për të plotësuar kërkesën e ushtrimit nr. 3, që nxënësit të përgatisin artikuj për gazetën e shkollës, ata i ndajmë në grupe duke e mbushur me ngjarje të ndritshme dhe interesante.

Secilit grup i përcaktohet nga një teme. Paraqiten disa ide:

Gr. 1. lojëra,



- Gr. 2. konkurs vizatimi;
- Gr. 3. tregim të shkurtër;
- Gr. 4. sport;
- Gr. 5. poezi;
- Gr. 6. modë;
- Gr. 7. ngjarje interesante në shkollë;
- Gr. 8. familja;
- Gr. 9. ushqimi i shëndetshëm etj.

Udhëzohen nxënësit të mbledhin sa më shumë informacione për temën e dhënë, të shkëmbejnë idetë e tyre dhe aftësitë me ekipin dhe të gjithë së bashku të krijojnë disa artikuj interesantë.

Reflektim.

Punë me fletore pune.

Në mënyrë të pavarur u përgjigjen pyetjeve rreth gazetës së shkollës.

Detyrë:

Ushtrimi 4 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

MËSIMI 10

SI TË SILLEMI NË SITUATA TË NDRYSHME

Arritjet e të nxënësve: Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë:

- Të njohë rëndësinë e mirësjelljes në situata të ndryshme.
- Të shpjegojë dhe respektojë rregullat e sjelljes në shkollë.

Metodat dhe teknikat: bashkëbisedim, punë në grup.

Korrelacion: edukim muzikor, njohuri për shoqërinë.

Fjalë kyçe: ndjenjë, situatë, ndihmë.

Mjetet e mësimit: teksti mësimor, fletore e punës, projektor.

Evokim.

Mësuesi ndez muzikën me këngën e preferuar të nxënësve. Nxënësit i përgjigjen pyetjes se si u ndjenë kur dëgjuan muzikën. Çfarë kënaqësie ju sjell?

Pas saj paraqet një zhurmë të madhe të komunikacionit dhe borive që dëgjojnë në rrugë! U përgjigjen pyetjeve se si ndihen kur e dëgjojnë këtë pjesë.

Në projektor paraqitet një dhuratë e nxënësit. Tregojnë e si ndjehen kur marrin ndonjë dhuratë. Në rastin tjetër paraqitet një situatë kur fëmijët tallin e përqeshin një nxënë. Komentohet bashkë me nxënësit kjo situatë, diskutohet se si duhet të jetë ndjerë ai nxënë. Paraqitet një pamje tjetër e fëmijëve në këndin e lodrave, fëmijët duke ndihmuar të moshuarit dhe analizohen disa pamje të ndryshme.

Kërkohet që nxënësit të tregojnë mënyrën e kujdesit ndaj natyrës, ndaj njerëzve të tjerë, ndaj kafshëve, ndaj shpendëve etj.

Tregojnë si ndihen kur ndihmojnë dikë.

Para nxënësve paraqitet thënia: “Të kërkossh ndihmë është njerëzore, por të ofrosh ndihmë është edhe më njerëzore”.

Realizim kuptimi.

Tregohet figura ilustruese hyrëse e tekstit mësimor, nxënësit përshkruajnë me nga një fjali portretet e paraqitura të fëmijëve (ndjenja gëzimi, kënaqësie, hidhërimi, zemërimi, frike, trishtimi etj.).

Kërkohet që nxënësit të lexojnë dy tregimet e dhëna, të analizojnë dhe t'u përgjigjen pyetjeve rreth tregimeve.

Nxënësit tregojnë si veprojnë kur dikush ka nevojë për ndihmën e tyre:

shoku apo shoqja nëse lëndohet, një person i moshuar, një shok apo shoqe që ka nevojë për ndonjë detyrë, moshatar i tyre me aftësi ndryshe etj.

Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup ka nga një situatë me të cilën do të përshkruajë mënyrën se si do të ndihmojnë dikë:

Gr. 1. Shoku/ shoqja nuk di të ngasë biçikletën.

Gr. 2. Shoku /shoqja nuk di të vizatojë.

Gr. 3. Shoku ose shoqja ka vështirësi të luajë lojën që kemi vendosur të luajmë.

Gr. 4. Shoku /shoqja ishte sëmurë për disa ditë dhe vjen në shkollë.

Reflektim.

Punë me fletore pune.

Kërkohet që nxënësit të tregojnë si ata mund të ndihmojnë në punët e shtëpisë, vendosin shenjën [v] tek punët, që ata mund t'i bëjnë dhe shenjën [x] tek punët, që nuk mund t'i bëjnë.

Udhëzohen nxënësit që të punojnë ushtrimin nr. 2 dhe nr. 3. Kontrollohet puna e tyre.

Detyrë:

U kërkohet nxënësve për detyrë shtëpie të përshkruajnë një situatë kur janë ndier të gëzuar.

MËSIMI 11

Arritjet e të nxënit: Në fund të mësimit nxënësit do të jenë të aftë:

→ Të zhvillojnë ndjeshmëri për respektimin e rregullave kryesore të shkollës.

→ Të analizojnë personazhet, duke u bazuar në veprimet e tyre.

→ Të kuptojnë se duhet të respektohen kërkesat dhe të drejtat e tjetrit.

Metodat dhe teknikat: bashkëbisedim, punë në grup.

Korrelacion: njohuri me shoqërinë.

Fjalë kyçe: rregull, mirësjellje.

Mjetet e mësim: teksti, fletore e punës, projektor.

Evokim.

Nxënësit ftohen të tregojnë lojërat e tyre të preferuara, duke i paraqitur ato në tabelë p.sh.: basketbolli, futbollli, loja me litar etj.



Realizim kuptimi.

Rikujtojmë që çdo lojë ka rregullat e veta dhe ndjekja e rregullave na ndihmon që të bëhemi më të kujdesshëm me njëri-tjetrin, më të përgjegjshëm.

Nga zbatimi i rregullave gjatë lojës të gjithë përfitojnë të drejta të barabarta.

Ndjekim rregullat në lojë që të mënjanojmë konfliktet dhe argëtohemi më shumë. Përveç rregullave të lojës, nxënësit ndjekin edhe rregullat e shkollës, të cilat i ndihmojnë të bashkëpunojnë për të pasur sukses. Tregohemi të kujdesshëm që të mos i lëndojmë të tjerët, as ndjenjat e njëri - tjetrit, tregohemi të sinqertë, punojmë në qetësi pa shqetësuar të tjerët.

Udhëzohen nxënësit që të lexojnë rregullat e sjelljes së mirë.

Në klasë krijohen dy situata të ndryshme. Në situatën e parë nxënësit, duke vrapuar në klasë, rastësisht i hedhin librat e një shoku në tokë. Në këtë situatë i kërkojnë falje dhe ndihmojnë shokun të mbledhë librat, duke u penduar për situatën e krijuar.

Në situatën e dytë nuk kërkojnë falje, por fillon grindja mes tyre. Analizohen të dyja situatat nga nxënësit dhe nxirret përfundimi se cili veprim është i drejtë.

Ushtrimi nr 1. Lexohet nga nxënësit. Kërkohet të përcaktojnë cilat fjali përshkruajnë rregullat e mirësjelljes.

Ushtrimi nr. 2 kërkon që nxënësit të përshkruajnë për çdo ilustrim një shembull të sjelljes së mirë dhe një shembull të sjelljes së gabuar.

p.sh. në kinema nuk pengojmë të tjerët, nuk bëjmë zhurmë, sjellje e mirë; sjellje e gabuar: përdorim telefonin në kinema, ngrihemi në këmbë duke penguar të tjerët etj.

Reflektim.

Ushtrimi nr. 3. Shkruajnë një dialog duket u bazuar në imazhet e paraqitura, vëzhgohen dhe ndihmohen nëse kanë vështirësi.

Udhëzohen nxënësit që të punojnë ushtrimin 1 dhe 2 në fletore pune dhe diskutohet për situatat e paraqitura.

Me ndihmën e ushtrimit nr. 4 mësojnë rregullat themelore gjatë qëndrimit në tavolinë.

Detyrë:

Të përshkruajnë një rast në klasë kur sjellja e mirë i ka ndihmuar të zgjidhin një situatë të vështirë.

MËSIMI 12

SI TË SHPREHEMI ME MIRËSJELLJE

Arritjet e të nxënës: Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë:

- Të përdorë shprehjet: Më fal! Faleminderit! Ju lutem!
- Të tregojë situata të tjera ku përdoren këto përshëndetje.
- Të luajë në role situata të ngjashme me ato në libër.

Metodat dhe teknikat: bashkëbisedim, punë në grup.

Korrelacion: edukim muzikor, njohuri për shoqërinë.

Fjalë kyçe: fjalët magjike.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore e punës, tabak letre.

Evokim.

Mësuesi fillon orën e mësimi me këngën e fjalëve magjike. Analizojmë fjalët e këngës dhe veçojmë fjalët magjike.

Realizim kuptimi.

Nxënëve u shpërndahen fletët dhe kërkohet që ata të shkruajnë fjalët përshëndetëse që dinë. I lexojmë së bashku dhe tregojmë kur i përdorim ato. Fjalët magjike shkruhen në një tabak letre dhe vendosen në kënd të klasës.

Diskutohet me nxënësit mënyra e përshëndetjes së tyre me shokë /shoqe dhe mënyra e përshëndetjes me mësuesit ose ndonjë të moshuar.

Kuptojnë që kur duam t'i drejtohem një personi me respekt dhe nderim, në vend të përemrit **ti** përdorim përemrin **ju**.

Për të pasur me të qartë përdorimin e përemrit nxënësit punojnë ushtrimin nr. 1 të tekstit mësimor duke vendosur përemrin Ju ose ti në situatat e dhëna.

Udhëzohen nxënësit të punojnë detyrën nr, 2 dhe 3. Pasi i punojnë ato diskutohen në klasë.

Ushtrimi nr. 4. Nxënësit diskutojnë për proverbat e dhëna dhe kuptimin e tyre, nxënësit zgjedhin njërën prej tyre dhe e shtjellojnë në fletore, shprehin lirshëm mendimet e tyre.

Reflektim.

Pune me fletore pune. Nxënësit u përgjigjen kërkesave të detyrës 1, 2 dhe 3 në mënyrë të pavarur.

Në fletore shkruajnë një histori që u ka ndodhur dhe që janë treguar të sjellshëm me të tjerët.

Detyrë:

U jepet detyrë shtëpie të zgjedhin një nga proverbat e Ushtrimit 3 dhe ta shpjegojnë me një paragraf.



PJESA E DYTË

MËSIMI 13

PËRDORIMI I SHKRONJËS SË MADHE

Arritjet e të nxënit: Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë:

- Të njohë dhe të zbatojë rregullat themelore të drejtshkrimit.
- Të korrigjojë përdorimet e gabuara të shkronjës së madhe.
- Të përdorë saktë shkronjën e madhe dhe shenjat e pikësimit.

Metodat dhe teknikat: bashkëbisedim, shpjegim, demonstrim, punë me grupe.

Korrelacion: njohuri për shoqërinë.

Fjalë kyçe: shkronjë e madhe, pikësim.

Mjetet e mësimit: teksti mësimor, fletore e punës, mjete të përgatitura më parë nga mësuesi.

Evokim.

Nxënësve u shpërndahen fletat A4 në të cilat kërkohet që çdo nxënës të shkruajë emrin dhe mbiemrin e vet _____. Në fletë vazhdojnë të shkruajnë emrat e pjesëtarëve të familjes, mamit_____, babit_____, vëllait _____, motrës_____, gjyshit nga babi_____, gjyshit nga mami_____, gjyshes nga babi_____, gjyshes nga mami_____.

Vendin ku jetojnë_____, lumin më të afërt _____, malin më të afërt_____, emrin e shokut_____, emrin e shoqes_____.

Diskutohet për emrat e shkruar, kujtojmë së bashku kur përdoret shkronja e madhe.

Realizim kuptimi.

Shkronja e madhe përdoret për të dalluar emrat e përveçëm nga emrat e përgjithshëm, për të dalluar njerëzit, kafshët, sendet apo vendet nga të tjerët.

Nxënësit lexojnë fragmentet në tekstin mësimor dhe vërejnë përdorimin e duhur të shkronjës së madhe.

Me shkronjë të madhe shkruhen: emrat e përveçëm, emërtimet gjeografike, emrat e gazetave, revistave, librave, shkurtimet, fjala e parë pas pikës, fillimi i rreshtit të ri etj.

Mbajnë mend përdorimin e drejtë të shkronjës së madhe.

Ushtrimi nr. 1. Plotësojnë kërkesën e detyrës duke përdorur shkronjën e madhe ku duhet.

Ushtrimi nr. 2. Nxënësit plotësojnë adresën e shtëpisë, duke pasur kujdes përdorimin e shkronjës së madhe.

Ushtrimi 3 dhe 4 punohet në mënyrë të pavarur.

Muzeu i Ulqinit

në rrugën “Iliria”

në aeroportin “Nënë Tereza”

sipërfaqja e Marsit
në Ministrinë e Arsimit
në teatrin e fëmijëve
revista “Malësia”
qyteti i Kotorrit

Punë me fletore pune. Udhëzohen nxënësit të plotësojnë kërkesën e ushtrimit 1 dhe 2, duke përdorur në mënyrë të duhur shkronjën e madhe.

Reflektim.

Ushtrimi 3. Përshkruajnë familjen, duke treguar kujdes gjatë përdorimit të shkronjës së madhe.

Nxënësit ndahen në grupe. Secili grup ka për detyrë brenda 5 minutave të shkruajë:

- Gr. 1. emra shtetesh;
- Gr. 2. emra lumenjsh;
- Gr. 3. emra malesh;
- Gr. 4. emra qytetesh;
- Gr. 5. emra fshatrash etj.

Vlerësohet saktësia e detyrës.

Pas përfundimit të detyrës u përgjigjen pyetjeve të detyrës nr 4.

Detyrë:

U jepet detyrë shtëpie të shkruajnë 4 shembuj për secilin rregull që mësuam mbi shkrimin e shkronjës së madhe.

MËSIMI 14

DISA RASTE TË SHKRIMIT TË ZANORES Ë

Arritjet e të nxënit: Në fund të mësimit nxënësi është i aftë:

- Të njohë dhe të zbatojë rregullat themelore të drejtshkrimit.
- Të shkruajë drejt zanoren ë në fjalë.

Metodat dhe teknikat: stuhi mendimesh, shpjegim, punë individuale.

Korrelacion: matematikë.

Fjalë kyçe: zanorja ë.

Mjetet e mësimit: teksti mësimor, fletore e punës, mjete të përgatitura më parë nga mësuesi.

Evokim.

Rikujtojnë nxënësit sa shkronja ka alfabeti i gjuhës shqipe. Si janë të ndara? Sa bashkëtingëllore dhe sa zanore kemi? Cili është dallimi në mes tyre?

Realizim kuptimi.

Mësuesi veçon zanoren ë dhe nxënësit shprehin lirshëm fjalët që përmbajnë këtë zanore.

Udhëzohen të lexojnë fabulën e dhënë në tekstin mësimor, nënvizojnë fjalët në të cilat përdoret zanorja ë. Analizohet dhe diskutohet rreth ngjarjes së fabulës.



Mbani mend! Nxënësit udhëzohen të shkruajnë dhe të mbajnë mend rregullat e përdorimit të zanores ë të theksuar dhe të patheksuar.

Para se të fillojnë me plotësimin e ushtrimeve në tekstin mësimor, mësuesi u shpërndan nxënësve nga dy fleta në të cilat janë të shkruara zanorja **e** dhe **ë**. Zanoren **e** e mbajnë në dorën e majtë, ndërsa zanoren **ë** në dorën e djathtë. Mësuesi plotëson bashkë me nxënësit ushtrimin nr. 1, duke treguar kujdes në përdorimin e drejtë të zanores **ë**.

Reflektim.

Mësuesi shpërndan për të gjithë nxënësit etiketa me fjalë, në të cilën mungon një shkronjë dhe kërkon që nxënësit të plotësojnë shkronjën që mungon me **e** apo **ë**. Vërejnë dhe kuptojnë dallimin. Plotësojnë kërkesat e ushtrimeve në tekstin mësimor dhe u përgjigjen pyetjeve të dhëna në fletore pune.

Detyrë:

Ushtrimi 5 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

MËSIMI 15

SHKRIMI I DISA BASHKËTINGËLLOREVE **ll** DHE **dh**

Arritjet e të nxënësve: Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë:

- Të njohë dhe të zbatojë rregullat themelore të drejtshkrimit.
- Të shkruajë drejt bashkëtingëlloret **ll** dhe **dh** në fjalë.

Metodat dhe teknikat: stuhi mendimesh, mësojnë dhe luajnë.

Korrelacion: edukim fizik.

Fjalë kyçe: bashkëtingëllorja **ll**, bashkëtingëllorja **dh**.

Mjetet e mësimit: teksti mësimor, fletore e punës, mjete të përgatitura më parë nga mësuesi.

Evokim.

Mësuesja shqipton bashkëtingëlloret **ll** dhe **dh**, pastaj **e** dhe **ë**. A ka dallime mes tyre? Ku qendron ndryshimi?

Realizim kuptimi.

Para se të fillojnë me plotësimin e ushtrimeve në tekstin mësimor, mësuesi u shpërndan nxënësve nga dy fletë në të cilat janë të shkruara bashkëtingëlloret **ll** dhe **dh**. Bashkëtingëlloren **ll** e mbajnë në dorën e majtë, ndërsa bashkëtingëlloren **dh** në dorën e djathtë. Mësuesi shqipton sa me shumë fjalë në të cilat përdoren bashkëtingëlloret **ll** dhe **dh**, ndërsa nxënësit ngrenë dorën me shkronjën e duhur të përdorur në fjalë. Vërejnë dallimin në mes dy bashkëtingëlloreve.

Plotësojnë kërkesat e ushtrimeve në tekstin mësimor, duke vërejtur përdorimin e drejtë të dy bashkëtingëlloreve.

Mësojnë dhe luajnë. Nxënësit ndahen në 4 grupe, njëri grup mban në duar shkronjën **D**, ndërsa grupi tjetër **H**, dy grupe të tjera kanë shkronjat **L**. Nxënësit lëvizin nëpër klasë, kur mësuesi u thotë “**Ndalo!**” nxënësit duhet të gjejnë shokun për të formuar shkronjat **ll** dhe **dh**. Mbas përfundimit të aktivitetit plotësojnë ushtrimin nr 1. Duke gjetur rrugën në labirint që duhet të kalojë nga **ll**-ja për të gjetur **dh**-në.

Reflektim.

Plotësojnë ushtrimet e tjera në mënyrë të pavarur.

Zbulojnë fjalëkryqin me fjalët (*mallëngjehem, dhurata, ballkon, mbledh, dhoma*).

Punë më fletore pune.

Përgjigjen në mënyrë të pavarur dhe plotësojnë kërkesat e ushtrimeve. Kontrollohen dhe vlerësohet saktësia e punës.

Detyrë:

Ushtrimi 4 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

MËSIMI 16

NDARJA E FJALËVE NË FUND TË RRESHTIT

Arritjet e të nxënit: Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë:

→ Të përdorë drejt shenjat e pikësimit, ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit dhe shkronjën e madhe.

→ Të zbatojë rregullat për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit.

Metodat dhe teknikat: shpjegim, punë me grupe, punë individuale.

Korrelacion: njohuri për shoqërinë.

Fjalë kyçe: ndarje fjalësh, rresht.

Mjetet e mësimit: teksti mësimor, fletore e punës, mjete të përgatitura më parë nga mësuesi.

Evokim.

Nxënësit ndahen në grupe. Secili grup në zarf ka një numër të rrokjeve me bashkimin e të cilave duhet të formojnë fjalë. Fitues është grupi, i cili i lidh i pari të gjitha rrokjet në mënyrën e duhur.

Diskutohet me nxënësit kur ata shkruajnë tregime, detyra etj. dhe arrijnë në fund të rreshtit, shohin që nganjëherë nuk u zë fjalën e plotë dhe duhet të dalin në rreshtin e ri, prandaj janë disa rregulla se si ndahen fjalët në fund të rreshtit.

Realizim kuptimi.

Mësojnë se fjalët ndahen në fund të rreshtit sipas rrokjeve p.sh. ko-dra, po-sta, dhura-ta etj. Një shkronjë e vetme nuk lihet asnjëherë në fund të rreshtit, nuk mund të ndahen fjalët njërrrokëshe, si *lis, mund, kap, hap* etj, as shenja e pikësimit nuk mbartet në rreshtin e ri.

Udhëzohen nxënësit të lexojnë informacionet nga teksti mësimor për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit.

Shkruajnë në fletore rregullat e drejtshkrimit dhe analizohen e sqarohen përmes shembujve të dhënë.

Ushtrimi nr. 1. Nxënësit lexojnë dhe plotësojnë fjalët me rrokjet që mungojnë (*libër, gjithmonë, ngadalë, bashkëtingëllore, paragraf*).

Udhëzohen dhe plotësojnë kërkesën e ushtrimeve nr. 2, 3 dhe 4. U drejtohen pyetje rreth asaj që kanë shkruar.



Para se të kalojnë në punë me fletore pune, u përgjigjen pyetjeve: a ndahen në fund të rreshtit fjalët njërrrokëshe? A mund të lihet në fund të rreshtit ose të kalohet në rreshtin tjetër një shkronjë e vetme? Si ndahet bashkëtingëllorja që ndodhet midis dy zanoresh? A mund të ndahen shkurtimet?

Reflektim.

Kërkohet nga nxënësit që të zhvillojnë ushtrimet nr. 1 - 4 në fletoren e punës.

Detyrë:

Ushtrimi 3 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

MËSIMI 17

SHKRIMI I PJESËZAVE MOHUESE NUK DHE S'

Arritjet e të nxënit: Në fund të mësimit, nxënësi do të jetë i aftë:

- Të njohë dhe të zbatojë rregullat themelore të drejtshkrimit.
- Të përdorë apostrofin kur shkruan pjesëzën mohuese s'.
- Të korrigjojë gabimet e bëra në tekst në përdorimin e pjesëzave mohuese.
- Të përdorë saktë pjesëzat mohuese nuk dhe s'.

Metodat dhe teknikat: shpjegim, punë me grupe, punë individuale.

Korrelacion: njohuri për shoqërinë.

Fjalë kyçe: pjesëza mohuese, s', nuk.

Mjetet e mësimit: teksti mësimor, fletore e punës, mjete të përgatitura më parë nga mësuesi.

Evokim.

Në tabelë mësuesi shkruan fjalitë:

- Ana mëson mirë.
- Arta këndon bukur.
- Mësuesi shkruan në tabelë.

Analizohen fjalitë e dhëna së bashku me nxënësit, rikujtojnë se fjalia me të cilën pohohet diçka është fjali pohore. Fjalitë e dhëna pohore i shndërrojmë në fjali mohore.

- Ana nuk mëson mirë.
- Arta nuk këndon bukur.
- Mësuesi nuk shkruan në tabelë.

Ose:

- Ana s' mëson mirë.
- Arta s' këndon bukur.
- Mësuesi s' shkruan në tabelë.

Veçohen fjalitë.

- Mësuesi nuk shkruan mirë.
- Mësuesi s' shkruan mirë.

Realizim kuptimi.

Analizojnë fjalitë e dhëna. Vërejnë që fjalitë me anë të të cilave mohojmë diçka janë fjali mohore. Gjatë kthimit të fjalisë mohore në një fjali pohore vërejnë rëndësinë e pjesës mohuese **nuk** dhe **s'** prandaj duhet të dimë ku dhe si t'i përdorim.

Mësojnë që pjesëzat mohuese **nuk** dhe **s'** kanë funksion të njëjtë dhe mund të përdoren në vend të njëra-tjetrës. Pjesëza mohuese **s'** përdoret më shumë kur flasim sesa kur shkruajmë dhe ajo shkruhet me apostrof.

Te fjalitë, që i kemi veçuar si shembull, kuptojmë që përdorimi i pjesës **s'** krijon më shumë vështirësi gjatë të folurit, sepse fjalët, që vinë pas saj, fillojnë me shkronja **s, sh, zh** dhe krijojnë këtë vështirësi.

Në këto raste në vend të pjesës mohuese **s'** është më mirë të përdoret pjesëza **nuk**.

Ana s' solli lodrat. Artani s' shënoi golin. Mësuesi s' zhvilloi sot mësim të ri.

Ana nuk solli lodrat. Artani nuk shënoi golin. Mësuesi nuk zhvilloi sot mësim të ri.

Nxënësit udhëzohen të plotësojnë kërkesën e ushtrimit nr. 1 dhe nr. 2, ku kërkohet të përdorin pjesën mohuese **s'** në vend të **nuk** dhe e kundërta.

Ushtrimi nr. 3 nxënësit gjejnë dallimet mes fotografive dhe përshkruajnë dallimet me 10 fjali, duke përdorur modelin e dhënë.

Reflektim.

Punë në fletore pune.

Plotësojnë kërkesat e ushtrimeve 1, 2 dhe 3 në mënyrë të pavarur.

Detyrë:

Ushtrimi 3 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.



PJESA E TRETË

MËSIMI 18

EMRAT E PËRGJITHSHËM DHE EMRAT E PËRVEÇËM

Arritjet e të nxënit: Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë

→ Të dallojë emrat nga fjalët e tjera, t'i klasifikojë dhe t'i analizojë ata.

→ Të dallojë emrat e përgjithshëm dhe emrat e përveçëm.

→ Të krijojë fjali duke përdorur emra të ndryshëm.

→ Të shkruajë drejt emrat e përveçëm.

Metodat dhe teknikat: Di- Dua të di-Mësova, punë me grupe, punë individuale.


Korrelacion: njohuri për natyrën.

Fjalë kyçe: emra të përgjithshëm, emra të përveçëm.

Mjetet e mësimit: teksti mësimor, fletore e punës, projektor.

Evokim.

Rikujtojmë njohuritë e fituara më parë për emrin.



Di	Dua të di	Mësova
Emri është fjalë që emërtan njerëz, kafshë, sende, vende, dukuri etj.	Cilët janë emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm dhe si shkruhen ata?	

Realizim kuptimi.

Udhëzohen nxënësit të lexojnë njohuritë për emrin nga teksti mësimor. Kuptojnë dallimin midis emrave të përveçëm dhe emrave të përgjithshëm.

Në tabelë paraqiten fotografitë. Pyeten nxënësit për emrat e fotografive dhe shkruhen në tabelë:

njeriu, lumi, qyteti, qeni. Ftohen nxënësit që pranë emrave të vendosin emra të veçantë: *Antoni, Moraça, Plava, Lupi.*

Diskutohet se si shkruhen këta emra të veçantë dhe pse shkruhen ashtu.

Emrat e veçantë që u vëmë njerëzve, kafshëve, sendeve dhe vendeve për t'i dalluar nga emrat e tjerë, quhen emra të përveçëm. Emrat e përveçëm shkruhen me shkronjë të madhe.

Në tekstin e dhënë dallojnë emrat e përgjithshëm dhe emrat e përveçëm, duke i renditur në tabelë, emrat e përveçëm të cilët tregojnë njerëz, kafshë dhe sende, si dhe emrat e përgjithshëm të cilët tregojnë njerëz kafshë dhe sende.

Tek ushtrimi nr. 2 dhe 3 plotësojnë fjalitë duke shtuar nga një emër të përveçëm dhe nga një emër të përgjithshëm.

Reflektim.

Ushtrimi nr. 4 punohet në mënyrë të pavarur. Kontrollohet dhe vlerësohet puna e nxënësve.

Di	Dua të di	Mësova
Emri është fjalë që emërton njerëz, kafshë, sende, vende, dukuri etj.	Cilët janë emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm dhe si shkruhen ata?	Emrat e përgjithshëm emërtojnë njerëz, sende, vende etj. në përgjithësi pa i veçuar dhe shkruhen me shkronjë të vogël. Emrat e përveçëm i dallojnë njerëzit, kafshët, vendet etj. nga të tjerët dhe shkruhen me shkronjë të madhe.

Punë me fletore pune. Udhëzohen nxënësit të lexojnë kërkesat e detyrave nga 1- 4, korrigjohen, inkurajohen dhe vlerësohen për punën e kryer.

Detyrë:

Ushtrimi 5 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

MËSIMI 19

GJINIA E EMRIT

Arritjet e të nxënit: Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë:

- Të njohë dhe të zbatojë rregullat për gjininë e emrave.
- T'i dallojë emrat e gjinisë femërore dhe gjinisë mashkullore në fjalitë e dhëna
- T'i klasifikojë emrat sipas gjinisë.

Metodat dhe teknikat: punë me grupe, punë individuale.

Korrelacion: njohuri për natyrën.

Fjalë kyçe: gjinia femërore, gjinia mashkullore.

Mjetet e mësim: teksti mësimor, fletore e punës, projektor.



Evokim.

Mësuesi kërkon nga nxënësit që një nxënës dhe një nxënëse të dalë para tabelës. Përshkruajnë dallimet në mes tyre.

Realizim kuptimi.

Mësuesi me anë të projektorit paraqet një fotografi të një nxënësi dhe një nxënëseje. Komentojnë fotografitë e dhëna, pastaj krahasohen dhe analizohen fotografitë e gjyshit dhe gjyshes, gjelit dhe pulës etj.

Nxënësit vërejnë që disa nga fotografi, paraqesin emra të gjinisë femërore, ndërsa fotografitë e tjera paraqesin emra të gjinisë mashkullore. Shkruhen në tabelë emrat e gjinisë femërore dhe mashkullore:

Emra të gjinisë mashkullore

nxënësi
gjyshi
topi
lapsi
zog

Emra të gjinisë femërore

nxënësja
gjyshja
çanta
pema
pula

Nxënësit përshkruajnë emrat dhe gjininë e emrit. Mësojnë që:

Emrat në gjuhën shqipe janë në gjininë femërore dhe në gjininë mashkullore.

Emrat e gjinisë femërore mbarojnë me -a ose -ja.

Emrat e gjinisë mashkullore mbarojnë me -i ose -u.

Përrashtim bëjnë disa emra të gjinisë mashkullore që mbarojnë me -a (daja, Kola) dhe disa emra të gjinisë femërore që mbarojnë me -i (mami, Kejsi).

Në detyrën e parë të tekstit mësimor vihen qartë dallimet mes gjinisë femërore dhe gjinisë mashkullore.

Në fabulën e dhënë nxënësit qarkojnë me ngjyrën blu emrat e gjinisë mashkullore dhe me rozë emrat e gjinisë femërore.

Ushtrimi nr. 1. Shkruajnë nga 5 emra të gjinisë femërore dhe mashkullore sipas modelit të dhënë.

Ushtrimi nr. 3. Nxënësit dallojnë dhe plotësojnë emrat, të cilët mund të marrin gjini tjetër, p.sh.:

nxënës emër i gjinisë mashkullore, në gjininë femërore do të ishte *nxënëse*. Vërejnë nëse emrat e tjerë mund t'i kalojnë në gjininë tjetër apo jo.

Nxënësit ndahen në 4 grupe dhe secilit grup i caktohet gjetja e emrave sipas kërkesës së veçantë.

Gr. 1. – emra të gjinisë mashkullore që përfundojnë me -i.

Gr. 2. – emra të gjinisë mashkullore që përfundojnë me -u.

Gr. 3. – emra të gjinisë femërore që mbarojnë me -a.

Gr. 4. – emra të gjinisë femërore që mbarojnë me -ja.

Para se të plotësohet kërkesa e detyrës së 4-t nxënësit kujtojnë që mbiemrat kanë të njëjtën gjini që kanë emrat me të cilët lidhen.

p.sh.:

djalë i vogël, vëlla i madh vajzë e vogël motër e madhe
Plotësojnë ushtrimin nr. 4 dhe nr. 5 në mënyrë të pavarur.

Reflektim.

Punë me fletore pune.

Në mënyrë të pavarur plotësohen ushtrimet 1-4. Lexohet dhe kontrollohet saktësia e tyre.

Detyrë:

Ushtrimi 5 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

MËSIMI 20

NUMRI I EMRIT

Arritjet e të nxënës: Në fund të mësimi nxënësit janë të aftë:

→ Të klasifikojnë emrat sipas numrit.

→ Të analizojnë emrat e dhënë në tekst.

Metodat dhe teknikat: luajmë së bashku, punë me grupe, punë individuale.

Korrelacion: matematikë.

Fjalë kyçe: numri njëjës, numri shumës.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore e punës, projektor.

Evokim.

Mësuesi kërkon që nxënësi të marrë në njërën dorë një laps, ndërsa në dorën tjetër një fletore. Lapsin e vendos në anën e djathtë të tij, ndërsa fletoren në anën e majtë të tij. Përshkruajnë ato cilësi që i dinë.

Fjala *laps* është emër i gjinisë mashkullore tregon send.

Fjala *fletore* është emër i gjinisë femërore që po ashtu tregon send.

Përsëriten së bashku me nxënësit, në anën e djathtë kanë një laps, ndërsa në anën e majtë kanë një fletore.

Kërkohet nga nxënësit që në anën e majtë të shtojnë edhe dy fletore të tjera dhe krahasojnë. Në anën e djathtë tani kemi një laps, ndërsa në anën e majtë kemi disa fletore. Vërejnë dallimin midis **një** dhe **disa**.

Themi që emrat janë në numrin njëjës dhe shumës. Emrat në numrin njëjës tregojnë vetëm për një njeri, një kafshë a një send. Emrat në numrin shumës tregojnë për dy ose më shumë njerëz, kafshë ose sende.

Realizim kuptimi.

Nxënësit udhëzohen të lexojnë tekstin e dhënë në tekstin mësimor, duke veçuar dhe shkruar emrat në numrin njëjës dhe emrat në numrin shumës. Në bazë të modeleve të dhëna kuptojnë rregullin si emrat nga numri njëjës kalojnë në numrin shumës, përshkruajnë dhe mbajnë mend rregullat.

Kur emrat kalojnë nga numri njëjës në shumës, mbaresat e tyre ndryshojnë.

Emrat e gjinisë mashkullore e formojnë shumësin:



Si në njëjës

Një blerës- disa blerës

Një shitës- shumë shitës

Me – e

Një qytet – disa qytete

Mendim- ca mendime

Me – ë

Një kryetar – disa kryetarë

Një shofer – disa shoferë

Me – a

Një stol – disa stola

Një libër – ca libra

Me – ra

Një mall- ca mallra

Shi – disa shira

Ka emra të gjinisë mashkullore që pësojnë ndryshime kur përdoren në shumës p.sh.:

një gjarpër – disa gjarpërinj, një kalë – disa kuaj, një lepur – disa lepuj.

Të mbajnë mend! Emrat e gjinisë mashkullore që në numrin shumës mbarojnë me **e**, kthehen në gjininë femërore p.sh.: male- male, qytet- qytete etj.

Disa emra të gjinisë femërore nuk ndryshojnë as në numrin njëjës, as në numrin shumës p.sh.:

një dritare – disa dritare, një rrugë – ca rrugë.

Udhëzohen nxënësit të plotësojnë kërkesën e detyrës nr. 2 të ndajnë emrat e dhënë në vendin e duhur në tabelë, duke dalluar numrin dhe gjininë e tyre.

Para se të plotësohet kërkesa e detyrës nr. 3 mësuesi shkruan në tabelë fjalinë:

Libri është miku im.

Kërkon nga nxënësit që emrin **libri** ta kalojnë në numrin shumës, duke treguar kujdes që edhe fjalët e tjera të kthehen në numrin shumës.

Librat janë miqtë e mi.

Vazhdojnë me detyra të tjera në mënyrë të njëjtë.

Reflektim.

Ushtrimi nr 4 kërkon që nxënësit të gjejnë nga 5 emra të cilët mbesin të njëjtë si në numrin njëjës, ashtu edhe në numrin shumës duke formuar fjali me këta emra

p.sh.: një nxënës – ca nxënës, një mace – ca mace, një dele – ca dele.

Punë më fletore pune. Kërkohet të punojnë ushtrimet 1- 4.

Detyrë:

Ushtrimi 5 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

Arritjet e të nxënës: Në fund të mësimit nxënësit do të jenë të aftë:

- të dallojnë dhe emërtojnë, emrat
- të përcaktojnë gjininë dhe numrin e tyre,
- t'i përdorin drejt ata në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Metodat dhe teknikat: shpjegim, punë me grupe, punë individuale.

Korrelacion: matematikë.

Fjalë kyçe: numri njëjës, numri shumës.

Mjetet e mësimit: teksti mësimor, fletore e punës, projektor.

Evokim.

Mësuesja paraqet një figurë të detit. Flasin dhe diskutojnë rreth detit.

Realizim kuptimi.

Lexohet teksti dhe ftohen nxënësit që të gjejnë emrat. Vihet re forma e tyre dhe ndalen tek kategoria e numrit. Bëhet dallimi i tyre në numrin njëjës me numrin shumës. Mësuesja i shkruan në tabelë emrat dhe fillon bashkë me nxënësit të nënvizojë ato emra që ndryshojnë në numrin shumës. Me projektor paraqet mënyrën e formimit të numrit shumës:

- ▶ me anë të mbaresave të shumësit (*shkollë-shkolla*)
- ▶ duke ruajtur të njëjtën formë si njëjësi (*mësues-mësues*)
- ▶ me anë të mbaresave dhe të ndërrimit të tingujve në të njëjtën kohë (*breg-brigje*)
- ▶ me anë të ndërrimit të tingujve (*zog-zogj*)

Disa emra ndryshojnë gjini në numrin shumës, në njëjës janë të gjinisë mashkullore, në shumës bëhen femërorë. Këta janë emra mashkullore, që në shumës marrin mbaresën -e ose -ra (*mal-male, fshat-fshatra*)

Një pjesë e emrave kanë dy trajta shumësi (*copë: copët-pesë mijë copë tulla, copat -dy copa bukë*)

Me -nj shkruhen edhe trajtat e shumësit të emrave mashkullore, si: *gjarpërinj (gjarpër), lëmenj (lëmë), lumenj (lumë), priftërinj (prift), shkëmbinj (shkëmb), thelpinj (thelb)* etj.

→ Kujdes! Shkruhen me -j shumësat: *kufij (kufi), të këqij, të këqija (i keq, e keqe)*.

→ Emrat femërorë që në trajtën e pashquar mbarojnë me një zanore të theksuar, në shumës marrin edhe një *ë* pas bashkëtingëllores, p.sh.: *shtëpi – shtëpitë, çati - çatitë, shami – shamitë*

Punohet bashkë me nxënësit ushtrimi nr. 1 që kërkon të vihen emrat në numrin shumës.

Pastaj kalohet tek ushtrimi nr. 2 ku nxënësit duhet të gjejnë dhe të korrigjojnë gabimet.

Kalohet tek ushtrimi nr. 3. Emrat e mëposhtëm kanë dy trajta shumësi. Vëreni cilat janë kuptimet e tyre për secilën formë dhe formoni nga një fjali me to.

Reflektim.

Punohet në mënyrë të pavarur ushtrimi 1-4. Kontrollohet puna.

Detyrë:

Ushtrimi 4 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.



Arritjet e të nxënës: Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë:

- Të dallojë fjalët që tregojnë cilësi.
- Të dallojë mbiemrat e nyjshëm dhe ata të panyjshëm.
- Të dallojë gjininë dhe numrin e mbiemrave.

Metodat dhe teknikat: demonstrim, punë në grup, gjeje dhe thuaje.

Korrelacion: njohuri për natyrën.

Fjalë kyçe: mbiemër, i panyjshëm, i nyjshëm.

Mjetet e mësimit: teksti mësimor, fletore e punës, projektor.

Evokim.

Luajmë lojën: gjeje dhe thuaje.

Mësuesi përgatit një ilustrim të mollës. Fton që një nxënës të shohë ilustrimin dhe të përshkruajë më sa më shumë fjalë p.sh.: *e kuqe*, *e ëmbël*, *e rrumbullakët*, *e shijshme* etj. Në bazë të përshkrimit që bëjnë nxënësit e tjerë, duhet të zbulojnë se çfarë është, loja mund të vazhdohet edhe me ndonjë kafshë. Në fund të lojës, pyetën nxënësit se fjalët: *e kuqe*, *e ëmbël*, *e rrumbullakët* çfarë janë dhe shkohet me eliminimin e mundësive.

A janë emra?

A janë përemra?

A janë folje?

Arrihet në përfundim që janë mbiemra.

Realizim kuptimi.

Kujtojmë njohuritë themelore që kemi mësuar më herët për mbiemrat. Mbiemri ka kategorinë gramatikore të gjinisë (femërore dhe mashkullore), të numrit (njëjës dhe shumës), lakohen nëpër rasi (emërore, gjinore, dhanore, kallëzore dhe rrjedhore). Mbiemrat shënojnë një cilësi të emrit dhe përshtaten me të në gjini, në numër dhe në rasë.

Në tabelë shkruhen disa shembuj, duke vërejtur cili mbiemër i përshtatet emrit.

Nënë: të shijshme, e dashur Nënë e dashur.

Shkollë e madhe, frikacak Shkollë e madhe.

Lule i forta, të kuqe Lule të kuqe

Analizohen emrat dhe mbiemrat duke vërejtur numrin dhe gjininë.

Në vazhdim shkruajnë dy shembuj të tjerë:

Shokë të mirë. Djalë punëtor.

Ushqime të shëndetshme. Film vizatimor.

Ftohen nxënësit të tregojnë çka tregojnë fjalët e nënvizuara. Vërejmë dy lloje të mbiemrit (i nyjshëm dhe i panyjshëm).

Mbiemrat ndahen në mbiemra të nyjshëm dhe të panyjshëm. Mësuesi paraqet me projektor ose shkruan në tabelë:

Mbiemra të nyjshëm

i bardhë

të bardhë

e bukur

të bukura

mbiemra të panyjshëm

shembullor

bardhosh

zeshkane

trime

Mbajnë mend që mbiemrat e nyjshëm janë mbiemrat që marrin para nyjën **i** dhe **të** në gjininë mashkullore, ndërsa nyjën **e** dhe **të** në gjininë femërore.

Mbiemrat e panyjshëm nuk kanë nyje.

Në tekstin mësimor nxënësit lexojnë tekstin e dhënë dhe nënvizojnë mbiemrat e nyjshëm me një vizë dhe mbiemrat e panyjshëm me dy viza.

Reflektim.

Ushtrimi nr. 1. Lidhin emrat me mbiemër me kuptim dhe formojnë fjali p.sh.:

Vajzë e sjellshme.

Plotësojnë në mënyrë të pavarur detyrat në vazhdim në tekstin mësimor dhe fletore pune. Diskutohet dhe vlerësohet puna e nxënësve.

Detyrë:

Ushtrimi 4 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

MËSIMI 23

PËREMRA VETORË

Arritjet e të nxënit: Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë:

→ Të dallojë përemrat vetorë në fjali.

→ Të lidhë përemrat me grupet e fjalëve dhe të krijojë fjali.

Metodat dhe teknikat: shpjegim, punë grupe, punë individuale.

Korrelacion: njohuri për natyrën.

Fjalë kyçe: përemër vetor, veta, numri

Mjetet e mësimit: teksti mësimor, fletore e punës, projektor.

Evokim.

Në tabelë shkruhen fjalitë:

Unë dëgjoj me vëmendje mësuesen.

Ti shkruan bukur.

Ai këndoi një këngë për shkollën. Ajo këndoi një këngë për shkollën.

Ne këndojmë me zë të lartë.

Ju vizatoni bukur.

Ata po shkruajnë letër për shokun. Ato po shkruajnë letër për shokun.

Ngjyrosen dhe veçohen përemrat.



Shkruan në tabelë fjalët: Unë (gishtin e drejtojnë nga vetja), ti (gishtin drejtojnë nga shoku apo shoqja që kanë pranë), ai / ajo (gishtin tregues drejtojnë nga një shok/shoqe që nuk e kanë pranë), ne ju, ata /ato janë përemra vetorë. Përemrat quhen fjalë të cilat zëvendësojnë emrat.

Analizojnë tekstin mësimor dhe diskutojnë mbi numrin dhe vetat e përemrit vetor.

Dallojnë:

Veta I (personi që flet) – UNË (njëjës) personat që flasin, ku është edhe folësi – NE (shumës)

Veta II (personi që dëgjon) – TI (njëjës), (personat që dëgjojnë) –JU (shumës)

Veta III (personi për të cilin flitet) AI/AJO (njëjës), personat për të cilët flitet- ATA/ATO (shumës)

Mbajnë mend! Përemrat vetorë të vetës I dhe II përdoren vetëm për njerëz.

Veta III zakonisht përdoret për të mos përsëritur një emër që është përdorur më përpara.

Këta përemra përdoren edhe për frymorë, edhe për sende.

Ushtrimi nr. 1 dhe Ushtrimi nr. 2 synojnë të tërheqin vëmendjen tek përshtatja e përemrit me foljen në vetë dhe në numër. Plotësojnë fjalitë e dhëna me përemra që mungojnë.

Udhëzohen të plotësojnë ushtrimet në fletore pune. Kontrollohet dhe vlerësohet puna e tyre

Detyrë:

Ushtrimi 4 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

MËSIMI 24

FOLJET KAM DHE JAM NË KOHËN E TASHME, TË PAKRYER DHE TË ARDHME

Arritjet e të nxënës: Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë:

→ Të njohë dhe të zbatojë rregullat themelore të morfologjisë.

→ Të krijojë fjalë me foljen e dhënë.

→ Të shkruajë një tekst të shkurtër, duke përdorur sa më shumë folje.

Metodat dhe teknikat: shpjegim, punë grupe, punë individuale.

Korrelacion: njohuri për muzikën.

Fjalë kyçe: folja *kam*, folja *jam*.

Mjetet e mësimit: teksti mësimor, fletore e punës, projektor.

Evokim.

Nxënësit dëgjojnë dhe këndojnë këngën “Sa do doja një qenush”.

Tekstin e këngës mësuesi e shkruan në tabelë ose e paraqet me videoprojektor dhe së bashku me nxënësit dallojnë dhe nënvizojnë foljet.

Kujtojnë se çfarë tregon folja dhe cilat janë kohët e saj.

Në tabelë pasqyrohet zgjedhimi i foljes nëpër veta.

Unë lexoj. **Ne** lexojmë.

Ti lexon. **Ju** lexoni.

Ai/ajo lexon. **Ata /ato** lexojnë.

Realizim kuptimi.

Në tekstin mësimor analizojnë zgjedhimin e foljes *kam* dhe *jam* në kohën e tashme, në kohën e pakryer dhe në kohën e ardhme, në numrin njëjës dhe në numrin shumës.

Ushtrimi nr. 1. Vendosin foljen *kam* dhe *jam* në tekstin e dhënë në formën e duhur.

Ushtrimi nr 2. Nxënësit ndahen në grupe. Secili grup formon nga 6 fjali me foljet *kam* dhe *jam* në tri kohë të ndryshme.

I plotësojnë me radhë ushtrimet, duke u bazuar në kërkesat e parashtruara.

Para se të plotësojnë ushtrimin nr. 5, kujtojnë:

Kujtojnë që fjalët, të cilat shprehin ose tregojnë veprime apo gjendje, quhen folje.

Kur: luan, lëviz, vrapon, mëson, lexon, ecën, udhëton – kryen veprime.

Kur: ngopesh, gëzohesh, fle, qëndron, ke, do, rritësh – nuk kryen veprim, por je në gjendje të caktuar.

Kur: bubullin, veson, agon, gjëmon – flasim për dukuritë e natyrës.

Reflektim.

Formojnë 6 fjali me tri folje që tregojnë veprim dhe 3 folje që tregojnë gjendje.

Udhëzohen dhe plotësojnë ushtrimet në fletore pune në mënyrë të pavarur. Kontrollohet dhe vlerësohet puna e tyre.

Detyrë:

Ushtrimi 5 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

MËSIMI 25

KOHA E TASHME DHE E ARDHME E FOLJES

Arritjet e të nxënës: Në fund të mësimin nxënësi do të jetë i aftë:

→ Të analizojë foljet në fjalitë e dhëna.

→ Të kuptojë konceptin e kohës së tashme dhe kohës së ardhme.

→ Të mësojë të identifikojë dhe të përdorë kohën e tashme dhe kohën e ardhme në fjali.

→ Të praktikojë ndërtimin e fjalive, duke përdorur kohën e tashme dhe kohën e ardhme.

Metodat dhe teknikat: përqasje idesh, punë me grupe, punë individuale.

Korrelacion: njohuri për shoqërinë.

Fjalë kyçe: fjali pyetëse, fjali nxitëse.

Mjetet e mësimin: teksti mësimor, fletore e punës, projektor.

Evokim.

Përcakton kohët e foljes në fjali.

Me anë të video-projektorit paraqiten fotografi ose vizatohen: zogu në fluturim, bora duke rënë dhe vajza duke vrapuar.

Shkruan dhe plotëson:

Zogu _____. Bora _____. Vajza _____.



Zogu fluturon. Bora bie. Vajza vrapon.

Ngjyrosen dhe veçohen fjalët *fluturon*, *bie* dhe *vrapon*.

Kujtojnë që fjalët të cilat shprehin ose tregojnë veprime apo gjendje, quhen folje.

Kur: luan, lëviz, vrapon, mëson, lexon, ecën, udhëton – kryen veprime.

Kur: ngopesh, gëzohesh, fle, qëndron, kë, do, rritesh – nuk kryen veprim, por je në gjendje të caktuar.


Kur: bubullin, veson, agon, gjëmon – flasim për dukuritë e natyrës.

Diskutohet për kohën e kryerjes së veprimeve në ilustrime. Në tabelën e paraqitur të tekstit mësimor vërejnë foljen në kohë të ndryshme. Përshkruajnë dhe mësojnë kohët e foljes.

Realizim kuptimi.

Udhëzohen të lexojnë ushtrimet nr. 1 dhe 2, në mënyrë të pavarur. Ushtrimi 1 kërkon të gjejnë formën e saktë të foljes në kohën e tashme dhe kohën e ardhme.

Ushtrimin nr. 3 e plotësojnë me ndihmën e grafikut



Punë me fletore pune. I plotësojnë me radhë ushtrimet, duke u bazuar në kërkesat e parashtruara.

Detyrë:

Ushtrimi 5 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

MËSIMI 26

KOHA E PAKRYER DHE KOHA E KRYER E THJESHTË E FOLJES

Arritjet e të nxënitis: Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë:

→ Të kuptojë pse dhe si përdoret koha e pakryer dhe koha e kryer e thjeshtë.

→ Të mësojë të identifikojë format e foljeve në kohën e pakryer dhe të kryer të thjeshtë.

→ Të praktikojë ndërtimin e fjalive, duke përdorur kohën e pakryer dhe kohën e kryer të thjeshtë.

Metodat dhe teknikat: - Shpjegim dhe diskutim, shembuj praktikë, punë në grupe, dramatizim dhe lojëra gjuhësore.

Korrelacion: Ndërtimi i fjalive korrekte gramatikore, përshkrimi i ngjarjeve historike, duke përdorur kohën e kryer të thjeshtë, analiza e përdorimit të kohës së pakryer dhe të kryer të thjeshtë në tekstet letrare.

Fjalë kyçe: folje, koha e pakryer, koha e kryer e thjeshtë, veprim i përfunduar, gjendje e vazhdueshme

Mjetet e mësimit: tabelë e bardhë dhe markera, letra dhe stilolapsa, kartolina me fjali në kohë të ndryshme

Evokim. Kërkoni nga nxënësit të ndajnë atë që dinë për kohën e kaluar të foljeve. Çfarë vepimesh tregohen me kohën e kaluar dhe si ndryshojnë nga kohët e tjera?

► Shkruani disa fjali në kohën e kryer të thjeshtë në tabelë, si p.sh.:

Ai shkroi një letër.

Ne vizituam muzeun.

Ajo pikturoi një peizazh.

Nënvizoni foljet dhe shpjegoni se si ato tregojnë veprime që kanë ndodhur dhe kanë përfunduar në të kaluarën.

► Shkruani disa fjali në kohën e pakryer në tabelë, si p.sh.:

Ai shkruante letra çdo ditë.

Ne vizitonim muzeun çdo të shtunë.

Ajo pikturonte peizazhe gjithmonë.

Nënvizoni foljet dhe shpjegoni se si ato tregojnë veprime që zgjatnin në të kaluarën ose përsëriteshin.

→ Diskutoni ndryshimin midis kohës së kryer të thjeshtë dhe kohës së pakryer. Koha e kryer e thjeshtë përshkruan veprime të përfunduara në të kaluarën, ndërsa koha e pakryer tregon veprime të vazhdueshme ose të përsëritura në të kaluarën.

Realizim kuptimi.

Ndajini nxënësit në grupe të vogla dhe jepini kartolina me fjali të papërfunduara. Kërkoni që çdo grup të përfundojë fjalitë duke përdorur kohën e kryer të thjeshtë ose kohën e pakryer sipas udhëzimeve.

Ushtrimi 1 kërkon të kthejnë foljet nga koha e tashme në kohën e kryer të thjeshtë. Në ushtrimin 2 duhet të kontrollojnë saktësinë e formave të foljeve dhe të korrigjojnë gabimet.

Në ushtrimin 3 duhet plotësuar tabela, duke zgjedhurar foljet. Për t'i ndihmuar u është dhënë nga një formë nëpër veta të ndryshme.

Ushtrimi 4 i nxit nxënësit të gjejnë formën e kërkuar të foljes dhe ta përdorin atë në fjali.

Reflektim

Kërkojuni nxënësve të reflektojnë mbi vështirësitë dhe çfarë u ka ndihmuar që ta kuptojnë më mirë temën. Lejoni disa momente për komentet e tyre dhe përgjigjuni pyetjeve që mund të kenë.

Detyrë:

Ushtrimi 4 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.



PJESA E KATËRT

MËSIMI 27

LLOJET E FJALIVE SIPAS KUPTIMIT

Arritjet e të nxënës: Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë:

- Të analizojë fjalitë në tekstet e dhëna.
- Të përdorë drejt shenjat e pikësimit (pikën, pikëpyetjen, pikëçuditjen).
- Të shkruajë fjali sipas kuptimit, formës dhe ndërtimit.
- Të përdorë shenjat e pikësimit në fjali.
- Të dallojë llojin e fjalive.

Metodat dhe teknikat: përqasje idesh, punë me grupe, punë individuale.

Korrelacion: njohuri për natyrën.

Fjalë kyçe: fjali pyetëse, fjali nxitëse.

Mjetet e mësimit: teksti mësimor, fletore e punës, projektor.

Evokim.

Në tabelë shkruhen fjalët:

Fshat; kaloi; Marku; i pushimet; në.

Rikujtojmë që *fjalët që bashkohen dhe lidhen me njëra-tjetrën për nga kuptimi quhen fjali*. Nga kjo vërejnë që fjalët e shkruara më lart, duhet renditur sipas kuptimit për të formuar fjalinë:

Marku i kaloi pushimet në fshat.

Çdo gjë që ne shohim ose e mendojmë, e tregojmë ose e shkruajmë me dy ose më shumë fjalë, është një fjali. Fjala fillon me shkronjë të madhe dhe në fund të fjalisë vendosim shenjën e pikësimit (.,! ose?).

Realizim kuptimi.

Në tabelë vizatohet ose paraqitet me projektor një pamje e ditës me diell.

Me ndihmën e ilustrimit formohen fjali të ndryshme:

Çfarë ditë është sot? Sot është ditë me diell. O, sa ditë e bukur kjo!

Si është dielli? Dielli është i nxehtë. Ua paska dalë dielli!

Nxënësit kuptojnë që me anë të fjalisë ne mund të pyesim, të përshkruajmë diçka, të shprehim një dëshirë, urim, mallkim, urdhër, këshillë, lutje etj.

Lexohen fjalitë në tekstin e dhënë. Tërhiqet vëmendja e nxënësve për intonacionin, me të cilin lexohen fjalitë si dhe për shenjat e pikësimit në fund të fjalive. Shpjegohen kuptimi dhe dallimi ndërmjet fjalive.

Nxënësit ndahen në 4 grupe. Secilit grup i përcaktohet lloji i fjalive, të cilat duhen gjetur në tekstin e dhënë.

Gr. 1 fjalitë dëftore Gr. 2 fjalitë pyetëse Gr. 3 fjalitë nxitëse Gr. 4 fjalitë dëshirore.

Ushtrimin nr. 3 dhe 4 e punojnë në mënyrë të pavarur.

Punë me tekstin mësimor.

Rikujtojmë:

Fjali dëftore - me a në të saj tregojmë diçka. Përfundon me pikë (.).

Fjali pyetëse – me anë të saj pyesim. Përfundon me pikëpyetje (?).

Fjali nxitëse – me anë të saj bëjmë një kërkesë, japim një porosi apo urdhër. Zakonisht përfundon me pikë (.); kur shoqërohet me intonacion urdhërues, përfundon me pikëçuditje (!).

Fjali dëshirore – me anë të saj shprehim dëshirë, urim ose mallkim. Përfundon me pikëçuditje (!).

Reflektim.

Ushtrimi nr. 1. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të dhëna se çfarë tregon secila fjali dhe me çfarë shenje pikësimi përfundon.

Ushtrimi nr. 2. Shkruajnë nga një fjali për secilën fjali.

Ushtrimin nr. 3 e punojnë në mënyrë të pavarur.

Detyrë:

Ushtrimi 4 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

MËSIMI 28

FJALITË POHORE DHE MOHORE; FJALITË E THJESHTA DHE TË PËRBËRA

Arritjet e të nxënës: Në fund të mësimi nxënësit do të jenë në gjendje:

- Të identifikojnë dhe krijojnë fjali pohore dhe mohore
- Të kuptojnë dallimin midis fjalive të thjeshta dhe të përbëra dhe t'i identifikojnë ato.
- Të identifikojnë dhe krijojnë fjali të thjeshta dhe të përbëra.
- Të përdorin fjalitë e thjeshta dhe të përbëra në mënyrë korrekte në komunikimin e tyre të përditshëm.
- Të dallojnë llojet e fjalive.

Metodat dhe teknikat: përqasje idesh, punë me grupe, punë individuale.

Korrelacion: njohuri për natyrën.

Fjalë kyçe: fjali pyetëse, fjali nxitëse.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore e punës, projektor, tabelë për të shkruar.

Evokim.

Shpjegoni shkurtimisht temën e mësimi.

Pyetini nxënësit se çfarë dinë për fjalitë dhe diskutoni shkurtimisht çfarë është fjalia.

Shkruani në tabelë:

Fjalitë pohore

Shpjegoni sesi fjalitë pohore shprehin një mendim pohues.

U jepen në tabelë disa shembuj të fjalive pohore:



Shiu filloi.

Nxënësit nxitojnë.

Flisni me zë të lartë.

Fjalitë mohore

Shpjegoni sesi fjalitë e mohore shprehin një mendim mohues, duke përdorur pjesëza si: nuk, s', mos etj.

U jepen në tabelë disa shembuj të fjalive mohore:

Shiu s'filloi.

Nxënësit nuk nxitojnë.

Mos flisni me zë të lartë.

Fjalitë e thjeshta

Shpjegoni sesi fjalitë e thjeshta kanë vetëm një folje dhe shprehin një mendim të vetëm.

U jepen në tabelë disa shembuj të fjalive të thjeshta:

Dielli shndrit.

Nxënësit mësojnë.

Lulja lulëzon.

Fjalitë e përbëra

Shpjegoni sesi fjalitë e përbëra përbëhen nga dy ose më shumë fjali të thjeshta të lidhura së bashku.

U jepen në tabelë disa shembuj të fjalive të përbëra.

Ai lexon dhe ajo shkruan.

Unë vij kur ti më thërret.

Reflektim

Drejtohen nxënësit të reflektojnë mbi konceptet e përvetësuara me anë të plotësimit të ushtrimeve.

Ushtrimi 1: Nxënësit lexojnë shembujt dhe përcaktojnë ç'lloj janë fjalitë e sjella. Në ushtrimet 2 dhe në ushtrimin 3 nxënësit krijojnë vetë fjali sipas llojeve të mësuara.

Detyrë:

U kërkohet të shkruajnë 4 veprime që duhet t'i bëjnë dhe 4 veprime që nuk duhet t'i bëjnë.

MËSIMI 29

PJESËT KRYESORE TË FJALISË

Arritjet e të nxënësve: Në fund të mësimit, nxënësi do të jetë i aftë:

- Të njohë dhe të kuptojë fjalët kryesore në fjali dhe funksionin e tyre;
- Të gjejë gjymtyrët kryesore, duke u bazuar në fjalitë e dhëna;
- Të përmbledhë njohuritë për kryefjalën dhe kallëzuesin.

Metodat dhe teknikat: bashkëbisedim, punë në çift, punë në grup.

Korrelacion: njohuri për shoqërinë.

Fjalë kyçe: pjesët kryesore të fjalisë, kryefjalë, kallëzues

Mjetet e mësimit: teksti, fletore e punës, projektor, tabelë.

Evokim:

Mësimdhënësi paraqet në video-projektor ose me anë të fotografive, pamje të ndryshme dhe përshkruhen bashkë me nxënësit etj.

Realizim kuptimi:


Formulohen fjalitë me anë të pamjeve të paraqitura.


Fëmijët luajnë. Djali lexon. Mësuesja shkruan. Vajza këndon.

Ngjyrosen fjalët: *fëmijët*, *djali*, *mësuesja* dhe *vajza* më ngjyrë të gjelbër, ndërsa fjalët *luajnë*, *lexon*, *shkruan*, *këndon*, me ngjyrë të kuqe.

Kujtojmë që gjymtyrët kryesore të fjalisë janë kryefjala dhe kallëzuesi.

Nxënësit udhëzohen të lexojnë informacionet e dhëna në tekstin mësimor dhe diskutohet për njohuritë mbi kryefjalën dhe kallëzuesin. Paraqiten në tabelë.





Kryefjala dhe kallëzuesi janë fjalët kryesore në fjali.

Nxënësit dëgjojnë bisedën që bën kryefjala dhe kallëzuesi, mbasi morën rolet kryesore në fjali.

Kur u bë Gramatika, ua ndau detyrat Kryefjalës dhe Kallëzuesit.

Gramatika: ju do të jeni gjymtyrët kryesore të fjalisë.

Po, Kryefjala dhe Kallëzuesi filluan të shtyheshin se kush ishte më i rëndësishmi, prandaj diskutuan për rolin e tyre.

Kryefjala: unë jam kryefjala. Gjithmonë jam në krye të fjalisë, edhe kur dal në fund ndonjëherë, më shqiptojnë fort. Prandaj kam më shumë punë se ti në fjali dhe unë dua të jem e para.

Kallëzuesi: ti do të jesh e para dhe je në krye të fjalisë, por unë jam bërthama e saj. Pa bërthamë nuk funksionon as fjalia, ndërsa ti nënkuptohesh edhe kur nuk të shkruajnë. Fjalia pa mua s'ka kuptim. Prandaj unë dua të jem i pari.

Gramatika: nuk e di pse shtyheni me fjalë. Ju nuk bëni dot pa njëra-tjetrën. Rolet i keni të barabarta. Po mungoi njëra, nuk bën tjetri, jeni si motër e vëlla.

Kryefjala dhe Kallëzuesi, pas fjalëve të Gramatikës, u pajtuan dhe vendosën që të mos ziheshin më.

Në tekstin mësimor të dhënë, nxënësit gjejnë kryefjalën dhe kallëzuesin dhe tregojnë më se shprehen.

Nxënësit ndahen në 6 grupe.

Gr. 1. Shkruan fjali, ku kryefjala shprehet me emër.

Gr. 2. shkruan fjali, ku kryefjala shprehet me përemër

Gr. 3. shkruan fjali, ku kryefjala shprehet me grup fjalësh.

Gr. 4 shkruan fjali, ku kallëzuesi shprehet me folje

Gr. 5. shkruan fjali, ku kallëzuesi shprehet me grup fjalësh jam + emër

Gr. 6. shkruan fjali, ku kallëzuesi shprehet me grup fjalësh jam + mbiemër.

Udhëzohen nxënësit të plotësojnë ushtrimet në fletore pune. Kontrollohet dhe vlerësohet puna e tyre.

Detyrë:

Ushtrimi 4 dhe 5 në tekstin mësimor u jepen detyrë shtëpie.



Arritjet e të nxënësve: Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë

→ Të kuptojë dhe të përdorë pjesët plotësuese të fjalisë: grupin e kryefjalës, grupin e kallëzuesit

→ Të analizojë çfarë tregojnë grupet plotësuese: kohë, vend, mënyrë, shkak etj.

→ Të identifikojë dhe të krijojë fjali me pjesë plotësuese të fjalisë.

Metodat dhe teknikat: bashkëbisedim, punë në çift, punë në grup.

Korrelacion: njohuri për shoqërinë.

Fjalë kyçe: pjesët plotësuese të fjalisë, kryefjalë, kallëzues

Mjetet e mësimit: teksti mësimor, fletore e punës, projektor, tabelë; kartelë me fjalë dhe shprehje për secilën pjesë plotësuese të fjalisë

Evokim:

Mësimdhënësi paraqet në videoprojektor ose me anë të fotografive, pamje të ndryshme të fëmijëve, duke kryer veprime të ndryshme etj.

Realizim kuptimi:

1. Prezantimi i temës:

- Prezantimi i temës duke shpjeguar shkurtimisht çfarë janë pjesët plotësuese të fjalisë dhe rëndësinë e tyre në ndërtimin e fjalive.

- Jepni shembuj të thjeshtë në tabelë për të ilustruar çdo pjesë plotësuese të fjalisë (fjalitë e thjeshtë - fjalitë e zgjeruar).

2. Diskutoni me nxënësit për shembuj të përditshëm që ata kanë dëgjuar ose përdorur duke i pyetur për të identifikuar pjesët plotësuese të fjalës në ato shembuj.

3. Shpjegimi i pjesëve plotësuese të fjalisë:

- Prezantimi i çdo pjese plotësuese me shembuj konkretë.

- Në çdo rast, sigurohuni që të përshkruani se si secila pjesë plotësuese ndihmon për të dhënë më shumë informacion në fjali.

4. Demonstrim në tabelë:

- Krijoni fjali të thjeshta dhe më pas i zgjeroni duke shtuar pjesë plotësuese të ndryshme.

- Pyesni nxënësit për të ndihmuar në identifikimin e pjesëve plotësuese dhe vendosjen e tyre në fjali.


Reflektim:

Udhëzohen nxënësit për të plotësuar ushtrimet.

1. Ushtrime Individuale:

- Jepuni nxënësve fletë pune që përmbajnë ushtrime të ndryshme si identifikimi, plotësimi dhe krijimi i fjalive me pjesë plotësuese.

- Shëtisni nëpër klasë për të dhënë ndihmë dhe për të monitoruar përparimin e nxënësve.



2. Punë në grup:

- Ndani nxënësit në grupe të vogla dhe u kërkoni atyre të krijojnë fjali të përbëra, duke përdorur disa pjesë plotësuese.
- Grupi fitues do të jetë ai që krijon më shumë fjali korrekte.

Ushtrimi 1 synon që nxënësit të gjejnë çfarë shprehin pjesët plotësuese, duke bërë pyetjet e duhura.

Ushtrimi 2 Vetë nxënësit duhet të krijojnë fjali, duke përdorur si pjesë plotësuese fjalët e renditura në kërkesë.

Po ashtu veprohet edhe me plotësimin e ushtrimit 3.

Detyrë:

Ushtrimi 4 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

